

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7608 E enjte 2 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

**Javën e shkuar u përpoqa të gjej sado pak sens në mënyrën si po shkon procesi për formimin e institucioneve të reja të vetingut, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)...**

Vijon në faqen 20

Nga VINCENT W.J. VAN GERVEN OEI

**Ecuria e reformës në drejtësi, përtej afateve dhe përcaktimeve kushtetuese**



**Opinion** **Ditës**

**Nëse ke në dorë një dokument të tillë si raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit... e para gjë që lipset është serioziteti, çka do të thotë ta lexosh me kujdes...**

Vijon në faqen 21

Nga PERPARIM KABO

**Si e lexoj unë si qytetar raportin e DASH...**



Studimi, shqiptarët lanë 132 mln euro në lojëra fati

## Presidenti ktheu ligjin për kazinotë, Ahmetaj: Nuk ka asnjë ndryshim, vetëm unifikim procedure

“Meta rrëzoi parimin të mbrojtje dhe të jetë njësoj i aplikueshëm për të gjithë”

Ministria e Financave ka reaguar mbi vendimin e presidentit Ilir Meta, i cili me anë të një dekreti riktheu për rivotimin në Kuvendin ligjin për “Tatimin mbi të ardhurat”, duke shprehur rezervë për nenin 6 që trajton tatimin e lojërave të fatit. Ministria e Financave thekson se ato unifikojnë procedurën e tatimit për të gjitha...

Në faqen 5

## KESHILLTARI PER RAJONIN NE MEPJ: PO NEGOCIOJME VIJEN NDARESE NE KANALIN E KORFUZIT

# LIGJI I LUFTES, GREQIA JEP DRAFTIN E ABROGIMIT

Dervishi: Do përcaktohen mënyrat sesi qytetarët do marrin pronat e tyre. Dokumenti historik i tetorit 1940: Ndalohen pasuritë armike në Greqi



(Në foto) Dy kryeministrit, Edi Rama dhe Aleksis Tsipras

**“TIRANA PO ECEN MIRE”**  
Kryeministri me të rinjtë e FRESH: S’më shqetëson raporti të rinj-të vjetër në PS

Në faqen 4

**DETAJET E PROCESIT**  
Vetingu, konfirmohet në detyrë Hallunaj. PD: Skandal, liron nga burgu Frrokun

Në faqen 7

**INTERVISTA**  
Somayah Mohammadi: Jam me muxhahedinët me dëshirë, s’jam peng. Pse i shkruajta Xhafajt

Në faqen 9

**HAPAT E PROCEDURA**  
Lista me 619 personat që kanë gati lejet e legalizimeve, ALUZIONI: Emrat e përfuturve

Në faqen 18-19

**RAPORTI I FUNDIT**

**U-OCS**



**Observatori European: Bandat shqiptare të drogës po rriten, hapje edhe në Amerikën e Jugut**

Në faqen 8

Dokumentacioni i plotë që duhet të dorëzojnë studentët pranë sekretarive mësimore

## Udhëzimi, datat e aplikimeve për transferim studimesh

Ministria e Arsimit: Kategoritë që nuk kanë të drejtë të kandidojnë

Nga VOLTIZA DURO

Të gjithë ata kandidatë që dëshirojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi ose dëshirojnë të bëjnë transferim studimesh në një program të ciklit të parë, mund të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit



të lartë në periudhën 3-14 shtator 2018-të. Datat janë zbardhur një të interesuarit nëpërmjet një udhëzimi nga Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, e cila thekson se kandidatët mund të aplikojnë deri në 5 programe studimi para fillimit...

Në faqen 11





**Bushati: Kemi marrë draftin shoqëruar me memo shpjeguese për Ligjin e Luftës**

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati tha një muaj më parë gjatë një interviste televizive se kanë bërë një diskutim me palën greke dhe ajo u ka dhënë një draft për dekretin e Ligjit të Luftës bashkë me "një memo shpjeguese që do të pasojnë heqjen e gjithë luftës nga pikëpamja e konsekuencave ligjore". "E kam thënë dhe po e rithem, në asnjë moment nuk ndihemi të kërcënuar nga Greqia, sepse jemi ndër vendet anëtare të NATO-s dhe që kemi një rrugë të gjatë përpara është krejt normale dhe në kuadrin politik dhe psikologjik, kjo replikë e së kaluarës të shfuqizohet por nëpërmjet dekretit të presidentit". I pyetur se me çfarë efekti do të shoqërohet heqja e këtij ligji, Bushati ka sqaruar: "Me efektin që çdo shtetas shqiptar, sepse e kam thënë që ka tri kategori që preken nga Ligji i Luftës, shtetasit shqiptarë që u janë të sekuestruar pasuritë, shteti që mbarb dhe pakica greke. Për të tria këto kategori pala greke ka sjellë një memo shpjeguese për hapat që do të marrim. Ka një pronë në Greqi dhe deri sot nuk i drejtohet dot asnjë instance shtetërore për të marrë këtë pronë si pasojë e këtij dekreti me këtë do të behet e mundur që të kenë të gjithë të drejtën për ta gëzuar pronën".

Shqipëria dhe Greqia po secin drejt një kapitulli të ri në marrëdhëniet mes tyre. Dy vendet fqinje, me një histori të trazuar që nga Lufta e Dytë Botërore, po negociojnë një paketë marrëveshesh mes tyre. Ka vullnet politik dhe shpresë nga të dyja palët se viti 2018 do të zgjidhë çështjet që kanë tensionuar dhe helmuar marrëdhëniet mes tyre për më shumë se 70 vjet. Perspektiva europiane e Shqipërisë, paqja dhe stabiliteti në rajon janë karburanti drejt këtij kapitulli të ri. Dy kryeministrat, Edi Rama dhe Aleksis Tsipras shfaqen në një linjë kur, pas takimit të tyre në Samitin e Londrës, në kuadër të Procesit të Berlinit, shprehën bindjen se, "se shpejti mund të arrihen zgjidhje pozitive për këto çështje". Dhe fjala është për një paketë çështjesh në tri drejtime: e shkuara, e tashmja, e ardhmja mes dy vendeve dhe popujve.

**E shkuara: Heqja e Ligjit të Luftës nga Greqia, hap pozitiv kuptimplotë**

Mirëkuptim nga të dyja palët! Le të zgjidhim në krye të herës çështjet që trashëguam nga historia. Greqia hedh një hap kuptimplotë: zotohet të abrogojë Ligjin e Luftës me Shqipërinë. Ky ligj famëkeq, i miratuar në tetor 1940, kur Italia e Musolinit sulmoi Greqinë nga territori i Shqipërisë së pushtuar prej tij në pranverën 1939, është "de jure" sot e kësaj dite në fuqi. Më konkretisht: ky ligj do të thotë që Shqipëria për Greqinë është një vend armik! Armiqësi paradoksale ndaj një vendi anëtar të NATO-s, me të cilin në 1996, Greqia nënshkroi Traktatin e Bashkëpunimit dhe Fqinjësisë së Mirë! Paradoksale që tre vjet pas këtij traktati, në 1999, Greqia i bëri me dije Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë se "Ligji i Luftës është në fuqi". Situata tani ka ndryshuar, Greqia ka evoluuar 360 gradë qëndrimin e saj. Glevin Dervishi, këshilltar për rajonin në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, thotë për "Deutsch Welle": "Pala greke ka arritur që në negociatat e tanishme me palën shqiptare të kuptojë që Ligji i Luftës me Shqipërinë është një relike e historisë. Ajo është zotuar që abrogimi i tij të jetë pjesë e paketës së marrëveshjeve me Shqipërinë. Greqia na ka vënë tanimë në dispozicion një draft të abrogimit të ligjit, që duhet të bëhet me dekret nga Presidenti i Greqisë", thekson Glevin Dervishi.

**Fund sekuestros 78-vjeçare të pronave të shtetit dhe shtetasve shqiptarë në Greqi**

Abrogimi nga Greqia i Ligjit të Luftës me Shqipërinë do të nxjerrë nga

Këshilltari për rajonin në MEPJ: Po negociojnë vijën ndarëse në kanal in e Korfuzit

# Dervishi: Ligji i Luftës relike, Greqia na dha draftin e abrogimit

*"Do përcaktohen mënyrat sesi qytetarët do marrin pronat e tyre"*



Glevin Dervishi, këshilltar për rajonin në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme



**KUFIRI DETAR**  
"Procesi i negociatave për ndarjen e zonave detare mes dy vendeve udhëhiqet nga parimet e së drejtës ndërkombëtare, nga Konventa mbi të Drejtën e Detit, nga parimet e së Drejtës Kushtetuese dhe legjislacionet respektive. Të njëjtin proces Shqipëria ka bërë dhe me Italinë në vitet 1980-1990, sipas kritereve që përcakton konventa për sovranitetin dhe të drejtat sovraane", tha këshilltari i MEPJ.

ngër'i i stërgjatur marrëdhëniet mes dy shteteve dhe dy popujve fqinjë. Ai do të bëjë të mundur së pari heqjen nga sekuestro preventive e pronave të shtetit dhe shtetasve shqiptarë, që vazhdon që nga 1940. "Abrogimi i Ligjit të Luftës me Shqipërinë do të shoqërohet edhe me akte të tjera juridike, ku do të përcaktohen mënyrat dhe mekanizmat sesi shteti dhe qytetarët e Shqipërisë do t'u drejtohen institucioneve e organeve, të përcaktuara nga autoritetet greke për të provuar pronësinë e tyre dhe fituar të drejtën e marrjes së saj, në bazë të dokumenteve zyrtare që disponojnë", thotë për "DW", Glevin Dervishi.

**avantazhe, negociata për 'win-win'**

E tashmja e marrëdhënies me dy vendeve është përqendruar tek arritja e Marrëveshjes së Detit. Është fjala për detin Jon, ku Shqipëria dhe Greqia ndajnë mes tyre 3 hapësira: Det Territorial, Shelf Kontinental dhe Zonë Ekonomike Ekskluzive, këto dy të fundit kanë të bëjnë me shfrytëzimin e hapësirës dhe pasurive nëdetare si kërkimet për gaz, naftë etj. Kuptohet që për të 3 këto hapësira vendet kanë interesa strategjike. Si ndahen ato në detin e përbashkët Jon? Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit, që dy vendet e kanë ratifikuar, e thotë qartë me 320 nenet e saj. Zbatimi i Konventës bën të mundur që

dy vendet të ushtrojnë sovranitetin të plotë dhe të drejta sovraane secili në një zonë të përcaktuar qartë, me koordinata detare, të vendosura në një hartë të dakordësuar dhe të shoqëruar me koordinata detare për 3 hapësirat. Në rastin e Shqipërisë dhe Greqisë ka një pjesë, ku koordinatat detare në hartë mungojnë. Për këtë po negociohet tani mes dy palëve, thotë për "DW", Glevin Dervishi. "Kufiri i Detit Territorial Jon në kanal in e Korfuzit nuk ka një kufi të përcaktuar sipas kritereve të Konventës dhe të dakordësuar nga palët. Ajo që po bëjmë sot është negociimi për delimitimin e zonave detare në këtë zonë, sipas kritereve që përcakton Konventa", thekson ai. Negociatat vazhdojnë. Marrëveshja ende nuk po duket. Ka thënie dhe kundërthënie mes palëve. Kryeministri grek Tsipras, pas kthimit në Athinë nga Samiti i NATO-s, të zhvilluar në Bruksel, (11-12 korrik), 2018 tha në një konferencë shtypi, sipas materialit që Ambasada Greke në Tiranë, vuri në dispozicion të DE, se "jemi shumë afër një zgjidhjeje në lidhje me përcaktimin e Zonës Ekskluzive Ekonomike, duke ofruar avantazhe të rëndësishme për palën greke". Në këtë pretendim, kryeministri Tsipras është në një linjë me opozitën e djathtë në Shqipëri. Ish-kryeministri

Berisha akuzoi ditët e fundit kryeministrin Rama se me marrëveshjen që po negociohet tani "në mungesë të plotë transparence i ka futur Greqisë fushat më të mëdha të gazit dhe naftës të detit Jon". Avantazhet apo ndryshe falja e hapësirës detare Greqisë ka qenë një nga argumentet kryesore të Gjykatës Kushtetuese, kur ajo hodhi poshtë në vitin 2010, Marrëveshjen e Detit, të arritur kur kryeministër ishte Berisha dhe opozita e sotme ishte në pushtet. Gjykata Kushtetuese mori parasysh kërkesën ankimese të socialistëve, atëherë në opozitë dhe me votë unanime e rrëzoi marrëveshjen si "antikushtetuese, që karakterizohet nga moszbatimi i parimeve bazë të së drejtës ndërkombëtare për ndarjen e hapësirave detare midis dy vendeve dhe arritjen e një rezultati të drejtë dhe të ndershëm". (Vendim i Gjykatës Kushtetuese, Fq. 44). Opozita e sotme vazhdon ta quajë edhe sot e kësaj dite "korruptiv" vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2010. Ministri Bushati i deklaroi "DW" se "ka një strategji të qartë, të orkestruar për të mbajtur peng dhe mos lejuar që marrëdhënia shqiptarogreke të llojë energjinë që mundet". Gjithsesi, a ka gjasë që marrëveshja që po negociohet të mos jetë 'win-win' por 'win' vetëm për palën greke?

Glevin Dervishi thotë për "DE": "Procesi i negociatave për ndarjen e zonave detare mes dy vendeve udhëhiqet nga parimet e të drejtës ndërkombëtare, nga Konventa mbi të Drejtën e Detit, nga parimet e të Drejtës Kushtetuese dhe legjislacionet respektive. Të njëjtin proces Shqipëria ka bërë dhe me Italinë në vitet 1980-1990, sipas kritereve që përcakton Konventa për sovranitetin dhe të drejtat sovraane".

**E ardhmja - Marrëveshje e re partneriteti strategjik mes dy vendeve**

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati është optimist për rezultatet e negociatave lidhur me Marrëveshjen e Detit. Ai i tha "DE" në Tiranë se, "jemi në rrugë të mbarë për të arritur një marrëveshje që do të jetë e zbatueshme, e drejtë dhe shumë më e mirë se ato që kemi parë në të shkuarën".

Kryetari i grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho u shpreh dje se viti i pestë i qeverisë së Edi Ramës ka përkeqësuar ekonominë e familjeve shqiptare. "Mungesa e investimeve dhe përqendrimi i ekonomisë tek disa klientët të kryeministrit kanë ndikuar për keq në ekonomi, e cila nuk ka rritje reale që të ndikojë në rritjen e punësimit apo hapjes së vendeve të reja të punës. Statistikat e Edi Ramës se rritja ekonomike është 4.45 për qind janë përpjekje për të mashtruar shqiptarët", tha kryetari i grupit parlamentar të PD.

**Kreu i grupit të PD-së: Rama mashtroi për rritjen ekonomike**

**Spaho, akuza qeverisë: Ata që po vjedhin sot, nesër në burg**

Spaho theksoi se rritja ekonomike është vetëm 2.45%, ndërsa sipas tij, pjesën tjetër e zë shifra nga energjia elektrike. "E vërteta është se zëri kryesor i të ashtuquajturës rritje ekonomike është energjia elektrike. Numrat janë të pagabueshëm! 66.4 për qind të rritjes ekonomike e zë energjia elektrike. Thënë ndry-

she, rritja ekonomike prej 4.45 për qind ka ardhur për shkak të reshjeve të shiut dhe shites së energjisë elektrike. E zhveshur nga zëri i energjisë elektrike, ekonomia shqiptare rezultoi keq e më keq, me një rritje minimale prej 2.5 për qind, sepse energjia elektrike nuk prodhon punësim nuk hap vende të reja pune". Sipas Spahos,

ekonomia mund të njohë rritje reale vetëm: "Kur në Shqipëri të vijnë investime serioze të huaja, kur kryeministri të mos i shantazhojë investitorët e huaj që të punojnë me oligarkët e tij, kur kryeministri të mos e japë Shqipërinë me koncesion tek klientët e tij dhe kur kryeministri të mos e shndërrojë Shqipërinë në



kampionë të Europës për korrupsion, ku 1 në 3 tendra jepen pa garë".

Për Spahon, Shqipëria është vendi i vetëm në botë që nuk ka pasur asnjë investim serioz të huaj gjatë

pesë viteve të fundit. "Ata që po vjedhin sot, të jenë të sigurt se nesër do të do të shkojnë në burg për çdo qindarkë dhe pasuri të vënë me korrupsion", përfundoi Spaho.

**Kryeministri me të rinjtë e FRESSH: Nuk më shqetëson raporti të rinj-të vjetër në PS**

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama shprehu dje mbështetje për drejtimin e Tiranës nga kryetar i bashkisë, Erjon Veliaj. Gjatë një bashkëbisedimi me të rinjtë e Forumit Rinor Eurosocialist në Jalë, Rama foli për zgjedhjet vendore të vitit që vjen, duke thënë se do t'i kushtojë rëndësi kuotës gjinore dhe të rinjve. "Besoj që Tirana është në rrugën e duhur. Në Tiranë po bëhet maksimumi. Edhe në disa bashki të tjera, që e kanë këtë plagë shumë të madhe, unë besoj që po bëhet një punë shumë e madhe. Sigurisht që janë probleme pafund që nuk mbarojnë asnjëherë, por besoj që po bëhet një punë goxha sistematike", u shpreh dje Rama në bashkëbisedim me të rinjtë. E ndërsa u pyet për përfaqësimin e të rinjve dhe të vjetërve në PS, Rama në cilësimin e kreut të partisë u shpreh: "Mua personalisht s'më ka shqetësuar asnjëherë raporti të rinj-të vjetër, sepse vendoset në mënyrë të natyrshme. Më ka shqetësuar gjithmonë që në PS të ketë një raport të drejtë midis djemve dhe vajzave, burrave dhe grave. Vitin e ardhshëm të gjithë këshillat do t'i kemi 50 me 50 djem me vajza, gra me burra". Ndërkaq, kryeministri u tha të rinjve se qeveria do të investojë në arsimin profesional veçanërisht. "Nevoja për të pasur shumë më tepër njerëz të kualifikuar është e jashtëzakonshme, por edhe kërkesa ka filluar të rritet shumë që na imponon që dhe ne të bëjmë investime më shumë në arsimin profesional jo të mjaftueshme për hir të së vërtetës. Do të duhet të ishin shumë më tepër akoma", tha kryeministri. Rama u bëri thirrje qytetarëve të bëjnë durim, për shkak se reformat duan kohën e tyre. "Njerëzit janë absolutisht në të drejtën e tyre të mos kenë durim, se kanë pritur gjatë, por rrugë tjetër nuk ka. E vetmja rrugë është që të merren punët me radhë dhe nëse gjërat që ne po bëjmë sot, ose që kemi bërë në këto 4 vite e 9 muaj do shih bërë 24 vite përpara me këtë radhë, ne sot do ishim komplet diku tjetër",

**Zgjedhjet vendore, Rama vlerëson Veliajin: Tirana, në rrugën e duhur**

*"Vitin e ardhshëm në të gjithë këshillat, prioritetet barazia gjinore"*



Kryeministri Edi Rama

**FATMIR MEDIU**

Kreu i republikanëve akuzoi kryeministrin Rama për sabotim të qëllimshëm të institucioneve të drejtësisë. "Sabotimi i KLP dhe KLG është i qëllimshëm që të largojë gjyqtarë dhe prokurorë për të sjellë njerëz nga jashtë sistemit. Duhet të mendojmë pasojat e kësaj reforme. Ne nuk u ulëm së bashku për të vlerësuar reformën. PS injoroi marrëdhëniet me opozitën", tha Mediu në "News 24".

tha kreu i qeverisë. "Nëse reforma në drejtësi do ishte bërë me kohë e me vakt dhe nuk do ishte krijuar push-teti më i pavarur nga ligji dhe më i korruptuar, push-teti i drejtësisë, me gënjatës të kapur për fyti nga politikanët për interesat imediate të drejtpërdrejta të tyre dhe pastaj të lirë që të kapnin për fyti çdo njeri të zakonshëm, sot ne do ishim një vend tjetër, sepse do kishim një sistem drejtësie të formuar dhe funksional dhe me ato standarde që do ta bënin Shqipërinë një vend normal", deklaroi kreu i qeverisë. Si-

pas tij, "kështu për arsimin, për rrugët, janë një trashëgimi shumë e rëndë financiare për shkak të ngarkesave të mëdha që krijohen në buxhet, për shkak të borxheve të mëdha që u akumuluan, por edhe një trashëgimi e rëndë nga pikëpamja e asaj që kemi përfutur, sepse të gjitha duhen futur në standarde. Të gjitha. Kjo është ajo që po përpigëmi të bëjmë. Është një gjeneratë që pagoi dhe po paguan sot që po bën 30 vjeç dhe përbën koston e madhe të një rrugëtimi kuturo pa vënë bazat e shtetit dhe pa ndërtuar rrugën me radhë

**Deputeti socialist kërcënon me protestë, Ndreu: Pseudoreforma me shpikje banale...**

Deputeti i Partisë Socialiste në Lezhë, Pjerrin Ndreu ka reaguar ashpër kundër kompanisë OSHE-së. Deputeti thotë se zona e Tales në Lezhë është lënë 4 orë pa drita në kulmin e sezonit turistik. "Të lësh zonën turistike të Tales 4 orë pa drita në kulmin e sezonit turistik është kulmi i paafetësisë dhe talljes që strukturat e çakorduara të OSHE bëjnë. A pseudoreforma me shpikje banale kanë futur në qorrsozak menaxhimin e situatës. Si deputet zone kërkoi ndërhyrje të menjëhershme, ose do mbledh bizneset e asaj zone duke u vënë në krye të një proteste që nuk do jetë e lehtë për gjitha ata që e gatujnë këtë katrohurë turpi. S'më intereson aspak se kujt partie i përkasin, por çfarë zullumesh bëjnë në dem të sezonit turistik! Turp!", u shpreh dje Ndreu përmes një statusi në rrjetin social "Facebook".

**Raporti i DASH, Berisha: Problemet, 6 vula të zeza në fytyrën e 'Noriegës' dhe 'Zho Zho'-së**

Ish-kryeministri Sali Berisha ka komentuar raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit mbi klimën e investimeve për vitin 2018, ku Shqipëria vlerësohet si një vend i vështirë për të bërë biznes. Berisha numëron sipas tij problemet që ekzistojnë në vend dhe që evidentohen nga raporti. Ai thotë se janë 6 vula të zeza për kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj. Në këto problematika, Berisha numëron korrupsionin, mungesën e transparencës në prokurimet,



çështjet e pronësisë, praktikat PPP, favoret për kompanitë me lidhje politike. Sipas tij, "investitorët e huaj

kanë shqetësim të madh korrupsionin (sidomos në sistemin e drejtësisë), mungesën e transparencës në prokurimet publike dhe zbatimin e dobët të kontratave (pasigurinë juridike)". "Ndonëse reforma në drejtësi është në zbatim (përfshirë vettingun), investitorët e huaj kanë perceptim "problematic" mbi klimën e të bërit biznes dhe shprehen se Shqipëria mbetet një vend i vështirë për të investuar (...Albania remains a difficult place to do business)", komentoi Berisha.

"Presidenti ka rrëzuar parimin që synon të mbrojë dhe është njësoj i aplikueshem për të gjithë"

# Ministria e Financave reagon ndaj presidentit për tatimin e lojërave të fatit

"Nuk ka asnjë ndryshim në ligj, vetëm unifikim procedure"

Ministria e Financave ka reaguar mbi vendimin e presidentit Ilir Meta, i cili me anë të një dekreti, riktheu për rivotim në Kuvend ligjin për "Tatimin mbi të ardhurat", duke shprehur rezervat për nënin 6 që trajton tatimin e lojërave të fatit. Ministria e Financave thekson se ato unifikojnë procedurën e tatimit për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare, që me ligjin e vjetër ka qenë e përkrahshme. Nderkohë, kjo ministri më tej sqaron se ndryshimet e propozuara në ligj, për "Tatimin mbi lojërat e fatit" nuk sjellin asnjë ndryshim apo relaksim të tatimit për kategoritë e lojërave të fatit nga ligji i vitit 2015. Ndryshimet e ligjit u miratuan në muajin korrik me paketën e re fiskale, ku tatimi mbi të ardhurat 15% nuk do të llogaritet mbi xhiron, por mbi të ardhurat bruto, duke zbritur shumën që ju shpërndahet lojtarëve fitues. Ndryshimi i fundit ligjor që është rikthyer për rishikim nga Presidenti Meta, u interpretua nga Financat si një saktësim për të harmonizuar atë me ligjin bazë të lojërave të fatit që u miratua në vitin 2015.

## REAGIMI I MINISTRISË

Nuk ka asnjë ndryshim në ligjin "Për lojërat e fatit" dhe asnjë relaksim sa i përket tatimit mbi lojërat e fatit, përkundrazi ka njësim të aplikimit për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit. Kuadri rregullator dhe fiskal i lojërave të fatit është vendosur dhe standardizuar në vitin 2015 me Ligjin 155/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton konceptet, përkufizimin dhe mënyrën se si taten të gjitha kategoritë e lojërave të fatit. Neni 52/2 i këtij ligji përcakton shprehimisht se të gjitha kategoritë e lojërave të fatit taten në masën 15 për qind mbi të ardhurat bruto.

Neni 52, detyrimet tatimore 2.

Të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit taten në masën 15 për qind, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj të veçantë.

Në ligjin e sipërcituar, Neni 4, pikë 40, përcaktohet qartësisht baza e tatueshme, që është e ardhura bruto nga loja.

"Të ardhurat bruto nga loja" është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre. Është ky sistem fiskal dhe rregullator, të cilin presidenti në argumentet e tij e cilëson si "regjim fiskal dhe rregullator të rreptë, që synon shtimin e barrës fiskale, me qëllim dekurajimin e këtij aktiviteti". Dhe është pikërisht ky sistem fiskal, të cilin synon të



## Arsyet pse Presidenti Meta rikthen 'lojërat e fatit' në Kuvend

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i riktheu Kuvendit për rishqyrtim një tjetër ligj, pas ligjit për Teatrin Kombëtar. Presidenti vlerëson se ligji nr. 39/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar" duhet të vlerësohet edhe një herë nga Kuvendi, në mënyrë që kjo paketë fiskale të realizohet në atë mënyrë që të jetë tërësisht në interes të publikut dhe ekonomisë, duke mbështetur rritjen e mirëqenies familjare dhe aspektin e saj. "Duke krahasuar efektet pozitive që vijnë nga zba-

timi i barrës së lehtësuar fiskale ndaj operatorëve dhe bizneseve në fushën e lojërave të fatit, përkundrejt dramave sociale dhe konflikteve në familje që janë shkaktuar në vijimësi nga pjesëmarrja në lojërat e fatit arrihet në konkluzionin se iniciativa propozuese për të lehtësuar barrën fiskale përkundrejt bizneseve të lojërave të fatit, nuk është vlerësuar në mënyrë të thelluar nga qeveria dhe Kuvendi. Në aktet që shoqërojnë këtë propozim ligjor, nuk ekziston asnjë argument në këtë drejtim", argumenton presidenti.

## Nuk bëjnë sigurim jetë, shëndetësor apo shtëpie Shqiptarët lanë 132 mln euro për kazino e loto në 2017-ën, pritet rritje në 2018



Në vitin 2017 nuk kish në as Kampionat Botëror dhe as Europian, por kjo nuk e ka penguar industrinë e basteve dhe lojërave të fatit që të vijojë rritjen me ritme të shpejta, teksa numri i pikave sa vjen e po shtohet. Sipas të dhënave nga "Monitor", bazuar në xhirot e deklaruara të 14 kompanive kryesore të kazinove, basteve, lotto, bingo, lotari, qarkullimit vjetor zyrtar të industrisë ishte 16.6 miliardë lekë, ose rreth 132 milionë euro. Në krahasim me një vit më parë, shpenzimet e shqiptarëve për lotto e kazino janë rritur me 9.3%, apo rreth 11 milionë euro më shumë. Në 2016-ën, zgjerimi ishte 15%, ndërsa edhe në 2018 vlerësohet që ajo do të rritet ndjeshëm për shkak të Kampionatit Botëror dhe shtimit të pikave të lotove e basteve, që po shtrihen në kryeqytet e qytete të tjera të vendit, duke zëvendësuar baret e lokalet tradicionale. Këto janë vetëm shpenzimet zyrtare, teksa nuk llogaritet informalliteti që vlerësohet

i lartë në këtë sektor. Biznesi më i madh është tek kazino. Nga deklaratimet zyrtare, kazinot elektronike rezultojnë kategoria ku shqiptarët tentojnë të provojnë fatin, në zgjedhjen e bardhë apo e zezë, lojërat me fruta, slot machines etj. Në subjektet e licencuara nga Autoriteti si kazino elektronike rezultojnë të jenë shpenzuar 10 miliardë lekë, ose rreth 78

milione euro. Rritja e qarkullimit vjetor për kazinotë ka qenë minimale në 2017-ën. Në të kundërt, kompanitë e basteve sportive kanë parë një rritje të ndjeshme të të ardhurave në 2017-ën, ndonëse një vit i zakonshëm pa kampionate botërore apo europiane, i ndikuar nga shtimi i pikave të basteve nëpër qendrat e qyteteve. Për lotaritë dhe

bingot, shpenzimet janë më të ulëta, në rreth 5 milionë euro. Por, më shumë sesa individëve, që kërkojnë të bëjnë goditjen e jetës, fati u buzëqesh kompanive, që marrin 30-50% të të ardhurave si fitime dhe rezultojnë si sektori më fitimprurës në vend. Shpenzimet për frymë të shqiptarëve për kazino, lotto, bingo etj., kanë arritur në 46 euro në vitin 2017. Kjo shumë është e barabartë me atë që shpenzohet për t'u siguruar (tregu i sigurimeve në total ishte rreth 16.2 miliardë lekë në 2017-ën, sipas AMP-së), ku pjesën më të madhe, rreth 60% e zë sigurimi i detyrueshëm, tekta kultura e sigurimit në vend është shumë e ulët. Por, ndërsa shqiptarët ngurrojnë të sigurojnë jetën, shëndetin, apo shtëpinë, ata nuk hezitojnë që të lënë miliona në kërkim të fatit të shpejtë.

unifikojë ndryshimi i miratuar nga parlamenti dhe i kthyer nga presidenti. Kjo, sepse e vetmja kategori që bënte përjashtim nga ky rregull, ishte Lotaria Kombëtare, e dhënë me ligj të veçantë nga qeveria "Berisha" në vitin 2013, nr. 95/2013 "Për miratimin e marrëveshjes së licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoriteti i autorizuar dhe shoqërisë "Oesterreichische

Lotterien", GmbH, nëpërmjet shoqërisë "Olg project" shpk, sipas të cilit ky kategori lojërash është e tatueshme në masën 10%. Ndryshimi i

propozuar jo vetëm që nuk bën ndesh me rregullimin e vendosur në vitin 2015, por e unifikon këtë rregullimin duke përfshirë edhe Lotarinë

Kombëtare në të njëjtin kuadër fiskal.

Paragrafi i dytë, i pikës 7, të nenit 38, "Dispozita kalimtare", ndryshohet, si më

poshtë vijon: "Tatimi mbi lojërat e fatit sipas nenit 52/2, të ligjit nr.155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15% mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit i nr.95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre. Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji". Pra, nuk ka asgjë të re përse i përket shkallës tatimore apo bazës së tatueshme lidhur me tatimin mbi lojërat e fatit, por qëllimi i ligjvënësist i shprehur qartë në këtë parashikim ligjor është përcaktimi i një regjimi fiskal dhe rregullator të njëjtë, njësoj i aplikueshëm, për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit. Presidenti, nëpërmjet mos dekretimit, ndoshta pa dashje, ka rrëzuar pikërisht parimin që synon të mbrojë, pra parimin e një sistemi të rreptë dhe njësoj i aplikueshëm për të gjithë.

Nëse ndryshimet e kthyer nga presidenti nuk do të hyjnë në fuqi, atëherë do të kemi një trajtim të diferencuar të një subjekti në treg, i cili do të vijojë të taten me shkallë tatimore 10%.

**Përmbasur gjyqësore Genti Bushati nxjerr për shitje ne ankand pasurine :**

a) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurisë 592/1, volumni 10, Fage 248, ne zonen Kadastrele nr 1100, me sipërfaqe totale 3230 m2, e ndodhur ne adresen Barbutullsh Shkoder

b) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurisë 5232/1, volumni 9, Fage 3, me zonen Kadastrele nr 1100, me sipërfaqe totale 2300 m2, e ndodhur ne adresen Barbutullsh Shkoder.

2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja ne Ankand për pasuritë a) sipërshkruar, është në vlerën a) Për pasuritë "Toka Are" me sip 3230 m2, është në vlerën 439.538 lekë.

b) Për pasuritë "Toka Are" me sip 2360 m2, është në vlerën 321.148 lekë

Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 08.08.2018 ora 16:16 ne Zyrën e përmbasurës gjyqësore Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballe Gjykatës sa rrethi Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit te ankandit 10% te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

**STRATI** Shoqëria përmbasore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen ne ankand te pasurive te paluajtshme:

"Njësi" me sipërfaqe 62 m2, me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5127-4-2, Zona Kadastrele 8521, Volumni 34, Fage 193, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep. dhe Nr. 402 Kol., datë 19.01.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 11,577,384 Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 08.08.2018.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbasore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 14111, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë: Ja çfarë mund të ndihmojë në rritjen e pagave

# Kursi i këmbimit, Sejko: Nuk do të lejojmë mbiçmim të shpejtë të lekut

"14% rënie për kredinë me probleme"

**E**dhe pse Banka e Shqipërisë po ndërhyr për normalizimin e kursit të këmbimit, oferta për valutë vazhdon të jetë e lartë, e kjo për shkak të faktorëve sezonalë. Kjo është ajo çka ka deklaruar guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko ditën e djeshme. "Masat e fundit të politikës monetare dhe ndërhyrja në tregun e brendshëm valutave kanë rezultuar efektive - tha Guvernatori - dhe normat e interesit të lekut kanë ardhur në rënie në tremujorin e dytë. Kredia me probleme ka rënë rreth nivelet 14 për qind, ndaj bankat duhet të nxiten që të kreditojnë ekonominë", sugjeroi Guvernatori, i cili ka pohuar se treguesit e vrojtimit të kredisë njoftojnë për kushte dhe standarde me konservatore të bankave ndaj huadhënies. Duke marrë në konsideratë zhvillimet në inflacion, Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë ka vendosur të mos ndryshojë norman bazë të interesit, duke e lënë atë në nivelin e 1 për qind. Guvernatori pohoi se norma e interesit nuk do të ndryshojë para tremujorit të dytë të vitit 2019. Stimuli monetar mbetet konsistent me politikën fiskale për të kthyer inflacionin në objektiv 2020. Norma e interesit nuk ndryshon para tremujorit të dytë të vitit 2019. Guvernatori tha se ekonomia shqiptare vijoi të ndjekë një trend pozitiv zhvillimi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Aktiviteti ekonomik ka ardhur në rritje, duke mundësuar zgjerimin e punësimit, rritjen e pagave, përmirësimin e gjendjes financiare të bizneseve dhe forcimin gradual të presioneve inflacioniste, shkruan "Monitor". "Këto zhvillime - tha ai - janë mbështetur nga përmirësimi i ambientit të huaj, nga përmirësimi i besimit në ekonomi, nga kushtet e favorshme financiare, të diktuar nga politika jonë monetare lehtësuese, si dhe nga goditje pozitive të ofertës. Pritjet tona për të ardhmen mbeten pozitive. Megjithatë, materializimi i tyre kërkon ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare, ndërsa balanca e rrezeve mbetet e zhvendosur në kahun e poshtëm. Inflacioni mesatar i tremujorit të dytë regjistroi vlerën 2.2%, duke ardhur në rritje nga norma mesatare prej 1.9% e tremujorit të parë. Në veçanti, inflacioni shënoi vlerën 2.4% në



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko



## BANKA E SHQIPËRISE

Rënia e rrezeve të kredisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i bilanceve, sikundër ilustron nga rënia në nivelin 13.27% e raportit të kredive me probleme, duhet të gjejnë një pasqyrim më të mirë në politikën e kreditimit të sektorit bankar. Pas mbiçmimit të shpejtë të regjistruar në muajt prill-maj, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë arriti të qetësojë funksionimin e tregut të brendshëm valutave dhe të frenojë mbiçmimin e kursit të këmbimit.

muajin qershor. Balanca e presioneve inflacioniste vazhdon të formohet nga një trend gradual forcimi të presioneve të brendshme dhe nga luhajtje afatshkurtra të çmimeve të artikujve specifike të sportës së konsumit", tha Sejko. Ai shpjegoi se rritja e inflacionit në tremujorin e dytë pasqyroi efektin rezultant të dy goditjeve të kahut të kundërt. Nga njëra anë, rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare solli rritjen e kostove të prodhimit dhe ushtroi një ndikim rritës në inflacion. Nga ana tjetër, forcimi i kursit të këmbimit frenoi përcjelljen e presioneve të huaja inflacioniste në tregun vendës. Faktori i parë ka pasur një intensitet më të fortë veprimi në tremujorin e dytë, por efekti i tij vlerësohet të jetë më i shkurtër në kohë. Ekonomia shqiptare shënoi një rritje prej 4.45% në tremujorin e parë, dhe të dhënat e tërthorta flasin për ritme pozitive rritjeje edhe në tremujorin e dytë. Përsëritimi i ritmit të rritjes ekonomike në tremujorin e parë të vitit pasqyroi rritjen e shpejtë të prodhimit të energjisë elektrike, në përgjigje të kushteve të mira hidrike. Në terma më afatgjatë, zgjerimi i aktivitetit ekonomik u bazua te rritja e konsumit dhe e investimeve private, ndërkohë që deficitit i shkëmbimeve tregtare me jashtë u rrit dhe politika

Guvernatori tha se ekonomia shqiptare vijoi të ndjekë një trend pozitiv zhvillimi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Aktiviteti ekonomik ka ardhur në rritje, duke mundësuar zgjerimin e punësimit, rritjen e pagave, përmirësimin e gjendjes financiare të bizneseve dhe forcimin gradual të presioneve inflacioniste, shkruan "Monitor".

fiskale vijoi të mbetet në kahun konsolidues. Të dhënat e tërthorta sugjerojnë se këto tendenca zhvillimi janë mbartur edhe në tremujorin e dytë. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është shoqëruar me rritjen e punësimit dhe rënie në 12.5% të normës së papunësisë. Kjo normë përbën nivelin më të ulët historik të papunësisë të regjistruar në Shqipëri dhe sugjeron një përdorim gjithnjë e më të plotë të kapaciteteve prodhuese në vend. Në përgjigje të saj, INSTAT-i raporton se paga mesatare reale u rrit me 2.3% në tremujorin e parë, çka përbën një premisë pozitive për forcimin gradual të presioneve të brendshme inflacioniste. Tregu i brendshëm financiar vazhdon të shfaqet i qetë dhe likuid, por presionet mbiçmuese të lekut vijojnë të jenë të pranishme në segmentin e tij valutave. Masat e fundit të politikës monetare, ulja në nivelin 1.0% e normës bazë të interesit dhe ndërhyrja në tregun e brendshëm valutave, me objektiv frenimin e mbiçmimit të shpejtë të kursit të këmbimit kanë rezultuar efektive. Normat e interesit të lekut kanë ardhur në rënie në tremujorin e dytë. Normat e interesit të kredive, depozitave dhe letrave me vlerë në lekë shfaqen në nivele minimale. Kredia për sektorin privat regjistroi një rritje mesatare me 5% në tremu-

jin e dytë të vitit, me një kontribut më të balancuar në rritje midis kredisë në lekë dhe kredisë në valutë. Në përgjithësi, rritja e kredisë është në linjë me përmirësimin e moderuar të kërkesës për të. Megjithatë, vrojtimi i aktivitetit kreditues sugjeron se standartet dhe kushtet e kreditimit të aplikuar nga sektori bankar vijnë në tërësi të mbeten konservatore.

## KONSTATIMET

Banka e Shqipërisë konstaton se rënia e rrezeve të kredisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i bilanceve, sikundër ilustron nga rënia në nivelin 13.27% e raportit të kredive me probleme, duhet të gjejnë një pasqyrim më të mirë në politikën e kreditimit të sektorit bankar. Pas mbiçmimit të shpejtë të regjistruar në muajt prill-maj, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë arriti të qetësojë funksionimin e tregut të brendshëm valutave dhe të frenojë mbiçmimin e kursit të këmbimit. Megjithatë, analizat tona sugjerojnë se raportit i kërkesës dhe ofertës në tregun valutave mbetet i zbalancuar, pjesërisht dhe si pasojë e prurjeve të larta sezonale dhe se mbiçmimi i shpejtë dhe i mëtejshëm i kursit të këmbimit do të dëmtojë kthimin e inflacionit në objektiv në afatin e mesëm. Duke gjykuar mbi sa më sipër, Banka e Shqipërisë vlerëson se qëndrimi aktual i politikës monetare mbe-

tet i përshtatshëm. Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 1.0%, të mbajë të pandryshuar normat e interesit të depozitës dhe të kredisë njëditore, respektivisht në nivelin 0.1% dhe 1.9%, të vijojë programin e blerjeve në tregun valutave me synim frenim dhe mbiçmimit të shpejtë të kursit të këmbimit.

## POLITIKA MONETARE

Ruajtja e kahut stimules të politikës monetare në afatin e mesëm do të shërbejë nxitjes së kërkesës agregate, duke ndihmuar rritjen e punësimit, të pagave dhe të presioneve të brendshme inflacioniste. Stimuli monetar është konsistent me kahun konsolidues të politikës fiskale dhe mbetet një parakusht i nevojshëm për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2020. Në përputhje me parashikimet e skenarit bazë, si dhe në bazë të informacionit të disponuar, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se normalizimi i normave të interesit në tregun e brendshëm financiar nuk do të fillojë përpara tremujorit të dytë të vitit 2019.

## VETINGU VENDIMI

Kalojnë procesin Gentian Medja, Brunilda Kadi dhe prokurori Besnik Muçi

# Vetingu, konfirmohet në detyrë gjykatësi Dritan Hallunaj

PD: Lirimi nga burgu i Frrokut, shkak për të shkarkuar një gjyqtar

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmoi ditën e djeshme në detyrë gjykatësin e Krimeve të Rënda, Dritan Hallunaj. Gjyqtari Hallunaj, njëherësh kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor, doli "i pastër" nga vetingu. Sipas Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk janë konstatuar problematika me pasuritë e gjykatësit të karrierës.

### HETIMI

Gjatë seancës dëgjimore, Hallunaj u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të komisionit. Gjyqtari mësoi se në të tria shtyllat e procesit të rivlerësimit pasuria, figura morale dhe aftësitë profesionale rezultojnë pa probleme. Ndërsa nga hetimi i thelluar rezultoi se gjyqtari Hallunaj ka në pronësi një apartament 165 m<sup>2</sup> të blerë me kredi për vlerën e 49 mijë eurove në 2005 dhe një automjet tip "Benz". Gjyqtari shpjegoi se rasti i apartamentit ishte okazion për shkak të vështirësisë financiare të ndërtesit. Gjithashtu, edhe në shtyllën e figurës morale DSJK ka konstatuar përshatshmërinë e Hallunajt për të vijuar detyrën, pasi nuk janë gjetur kontakte të tij me eksponentë të krimit të organizuar. Komisioni u ndal gjatë në shtyllën e aftësisë profesionale, pasi ndaj gjykatësit ishte bërë një ankesë në 2015 nga Prokurori i Përgjithshëm i kohës, menjëherë pasi biznesmeni Arben Frroku ishte shpallur i pafajshëm, ndonëse mbi supë e rëndonte akuza e vrasjes së një oficeri policie. Trupa gjyqësore tha se këtë rast u administrua vendimi i Apelit për Krime të Rënda nga i cili rezultoi se vendimarrja për Frrokun është tërësisht e ndryshme, pasi ai është dënuar me burgim të përjetshëm, por në asnjë rast nuk evidentohen shkelje të kryera nga gjykatësi Hallunaj, i cili në shkallë të parë kryesonte trupën gjyqësore.

### REAGIMI I PD

Menjëherë pas vendimit për konfirmimin e Hallunajt në detyrë, reagoi në një deklaratë për shtyp deputeti i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj. Ai e cilësoi si të padrejtë konfirmimin në detyrë të gjyqtarit Dritan Hallunaj nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. "Konfirmimi në detyrë sot i gjyqtarit të Krimeve të Rënda, Dritan Hallunaj, përgjegjës për lirimin nga burgu të mikut të Edi Ramës, Arben Frroku, vrasësit të komisarit Dritan Lamaj, është kampanë alarmi për sistemin



### ENKELEJD ALIBEAJ

"Konfirmimi në detyrë i gjyqtarit të Krimeve të Rënda, Dritan Hallunaj, përgjegjës për lirimin nga burgu të mikut të Edi Ramës, Arben Frroku, vrasësit të komisarit Dritan Lamaj është kampanë alarmi për sistemin e ri të drejtësisë dhe provë e qartë se vetingu nuk po shkarkon gjyqtarë e prokurorë të korruptuar, të lidhur me krimin e organizuar", tha Alibeaj.

e ri të drejtësisë dhe provë e qartë se vetingu nuk po shkarkon gjyqtarë e prokurorë të korruptuar, të lidhur me krimin e organizuar", tha Alibeaj. Më tej deputeti u shpreh se lirimi nga burgu i një vrasësi ishte shkak i mjaftueshëm që gjyqtari Hallunaj të ngectë në "sitën" e vetingut. "Lirimi nga burgu i një vrasësi si Arben Frroku është shkak i mjaftueshëm për të shkarkuar nga detyra një

gjyqtar. Dhe nëse gjyqtari nuk shkarkohet, vetingu ka dështuar të kthejë besimin tek qytetarët. Organet e vetingut e mbrojtën se i duhet Ramës në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Nëse vetingu s'do të ishte politik, ai do ishte shkarkuar", u shpreh Alibeaj.

### KONFIRMIMET

Më tej në vijim të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u konfirmua në detyrë Prokurori i

Krimeve të Rënda, Besnik Muçi. KPK, duke u bazuar tek raporti i ILKDPI thuhet se subjekti ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin. Po ashtu, thuhet se nuk ka kryer fshehje pasurie dhe ka burime të mjaftueshme financiare. Nga verifikimet e KPK rezultoi se Muçi ka një tokë truall 366 m<sup>2</sup> dhe tokë bujqësore në Pogradec. Po ashtu, ai disponon një apartament në rrugën e 'Ali Visha' në Ti-

### BESNIK MUÇI

Në vijim të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u konfirmua në detyrë prokurori i Krimeve të Rënda, Besnik Muçi. KPK, duke u bazuar tek raporti i ILKDPI thuhet se subjekti ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin. Po ashtu, thuhet se nuk ka kryer fshehje pasurie dhe ka burime të mjaftueshme financiare.

në Rrugën e Elbasanit, e blerë prej 75 mijë euro, siguruar nga rroga dhe një hua që ajo ka marrë. Pas vendimit, Besnik Muçi tha se procesi ishte tejet i vështirë, por edhe pozitiv. Sipas tij, vetingu do të sjellë një reflektim dhe përgjegjësi të madhe për prokurorët dhe gjykatësit. Gjithashtu, ditën e djeshme KPK ka konfirmuar në detyrë edhe Gentian Medjan, gjyqtarin e Gjykatës Administrative. Medja e ka filluar karrierën si gjyqtar në vitin 2004 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në vitin 2013 është transferuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë. Sipas raportit të ILD-KPKI, deklarimi i pasurisë së gjyqtarit ishte i saktë, ndërsa rezultoi se subjekti nuk ka fshehur të ardhurat. E vetmja grua që kaloi para trupës gjyqësore ditën e djeshme ishte gjyqtarja Brunilda Kadi, e cila mori konfirmimin për të vijuar detyrën. Gjatë seancës së vlerësimit në KPK kishte rezultuar se gjyqtarja kishte bërë deklarim të saktë e kishte burime financiare të ligjshme. Gjyqtarja ka deklaruar një apartament 124 m<sup>2</sup> të marrë me kredi, në Lanabregas me bashkëshortin dhe dy automjete. Në relacionin gjatë seancës dëgjimore, u deklarua se gjyqtarja Kadi, njëkohësisht anëtare e KLD është e përshtatshme për të vijuar detyrën.

## Elisabeta Imeraj vendoset në krye të Prokurorisë së Tiranës, zëvendëson Dritan Rreshkën

Elisabeta Imeraj është vendosur në krye të Prokurorisë së Tiranës pas shkarkimit të Dritan Rreshkës, i cili nuk mundi të kalojë sitën e vetingut, duke mos justifikuar burimin e pasurisë së tij. Mësohet se komandimi i Elisabetës Imeraj në krye të Prokurorisë së Tiranës është bërë me ur-

dhër të Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme, Artë Marku. Elisabeta Imeraj ka nisur detyrën si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër në vitin 2004 dhe më pas në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Imeraj njihet si prokurore e çështjeve të

mëdha, mes të cilave ajo e Shullazit, apo e 9 imamëve të akuzuar për terrorizëm, për të cilët kërkoi 126 vjet burg. Elisabeta Imeraj ishte gjithashtu edhe pjesë e grupit të hetuesve për dosjen ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, së bashku me prokurorët Valdimir Mara dhe Besim Hajdarataj.



**VLORE** - Alarmi i dhënë nga një shtetas nga Vlo-  
ra në orët e para të  
mëngjesit të djeshëm për  
vendosje tritoli në makinë  
e tij ka alarmuar policinë.  
Ndërkohë që pas  
verifikimeve të bëra ka  
rezultuar se alarmi për  
vendosjen e një sasie ek-  
splozivi në automjetin tip  
"BMW" me targë AA 895  
TX ka qenë fals. Mësohet  
se denoncimi u bë nga sh-  
tetasi Gazmend Merka-



## Denoncoi për vendosje tritoli në makinë, policia: Alarm fals, e ndalua për armë pa leje

në policinë e Fierit. Ndërko-  
hë, blutë e Fierit bënë me  
dije se Merkaç u paraqiti në  
komisariat dhe këtu qyteti  
dhe deklaroi se në makinën  
e tij në qytetin e Vlorës i  
është vendosur lëndë ek-  
splozive. Sipas burimeve të  
mësipërme, ai ka pohuar se

mjeti ndodhej i parkuar në  
afërsi të Drejtorisë së Poli-  
cisë së Vlorës, në lagjen  
"Osman Haxhiu". Por, ish-  
in forcat xhenerie që hoqën  
këtë dyshim, pasi nga  
këqyrja e makinës, nuk re-  
zultoi asnjë sasi e lëndës  
plasëse. Sakaq, policia e Fi-

erit në bashkëpunim me atë  
të Vlorës nisën verifikimet.  
Ata kontrolluan makinën  
e Gazmend Merkaçit teksa  
ai ndodhej në komisariat  
e Fierit. Policia gjeti në  
makinën e Merkaçit një pi-  
stole të me 7 fishekë, të cilën e  
mbante pa leje. Gjatë mar-

rrjes në pyetje në policinë  
e Fierit, ai është shprehur  
se armën e mbante për  
vetëmbrojtje. Burime nga  
blutë e Vlorës thanë se i  
ndaluar Gazmend Merkaç  
rezulton person me prece-  
dent të mëparshëm pen-  
nalë. Në vitin 1996, ai është  
dënuar nga gjykata e  
qytetit bregdetar për ve-  
prën penale, grabitje nën  
kërcënimin e armëve,  
dënim për të cilin ka kry-  
er 8 vite burgim.

"Ka impakt negativ për çeljen e negociatave me Bashkimin Europian"

**O**bservatori Europian  
i Krimin dhe Sigurisë  
(EU-CS) i ka kushtu-  
ar një artikull zhvillimit të  
bandave shqiptare të drogës  
në mbarë botën dhe impaktin  
negativ që ka kjo për çeljen e  
negociatave me BE. Sipas EU-  
CS, organizatat kriminale sh-  
qiptare janë shumë aktive në  
trafikun e drogës. Përveç pro-  
dhimit të brendshëm, tani ata  
kanë hapur edhe rrugë të  
rëndësishme nga Amerika  
Jugut, bazuar në raporte të  
shumta ndërkombëtare.  
Bandat shqiptare kontrolojnë  
territore, prodhojnë in-  
vestime e gjithashtu  
ndikojnë në politikën sh-  
qiptare, thotë raporti i fun-  
dit "Open Society" mbi evolu-  
timin e krimin të organizuar  
në Shqipëri. "Shqipëria pro-  
dhon dhe eksporton sasi të  
mëdha marijuane sidomos në  
Europë, ndërsa është vend  
transit për heroinën dhe ko-  
kainën afgane, duke shërbyer  
si portë hyrëse për shpër-  
darjen e heroinës në Europë",  
shkruante Departamenti  
Amerikan i Shtetit në një  
raport në mars të këtij viti.  
Shqipëria është regjistruar  
në hartën globale të drogës  
dhe dallohet si vend  
prodhues dhe shpërndarës.  
Një raport botëror i drogës në  
vitin 2017 nga Kombet e Bash-  
kuara nxjerr prova konkrete  
për përfshirjen e grupeve  
kriminale shqiptare në  
trafikun e drogës në Europë.  
Agjencia Kombëtare Britani-  
ke e Krimin (NCA) thotë se  
kërcënimin i grupeve krimina-  
le shqiptare është dome-  
thënë. "Londra është baza e  
tyre kryesore, megjithatë ata  
janë shpërndarë në të gjithë  
Mbretërinë e Bashkuar". Por  
si pastrohen paratë e drogës  
në Shqipëri? "Open Society"  
raporton se sektori i ndërtim-  
it është kryesori, për të vazh-  
duar më pas me kazino të apo  
pikat e basteve. Aktivitetet e  
botës kriminale shqiptare  
kërcënojnë jo vetëm policinë  
ndërkombëtare dhe vëzh-  
guesit e brendshëm në vend.  
Këshilli Europian vendosi të  
shtyjë bisedimet për çeljen e  
negociatave për vitin tjetër.  
Pra, përpjekjet për ndalimin  
e krimin në Shqipëri nuk  
kanë qenë të mjaftueshme.  
Qeverisë shqiptare do t'i du-  
het të punojë nga tani e deri  
në mesin e vitit 2019 për të  
bindur Këshillin Europian  
të hapë negociatat. Deri në  
atë datë, premtimi "do  
luftojmë krimin e drogën pa  
mëshirë" i bërë nga Rama në  
vitin 2013 duhet të prodhojë  
rezultate konkrete.

# Observatori Europian: Bandat shqiptare të drogës po rriten ndjeshëm në mbarë botën

"Përveç prodhimit të brendshëm, ata kanë hapur  
edhe rrugë të rëndësishme nga Amerika Jugut"



Reports highlight continued growth of Albanian crime gangs

According to numerous international reports, Albanian criminal organisations are very active in drug trafficking. In addition to the  
tradition, there are now important routes from South America

### DASH

"Shqipëria prodhon dhe eksporton sasi të  
mëdha marijuane sidomos në Europë, ndërsa  
është vend transit për heroinën dhe kokainën  
afgane, duke shërbyer si portë hyrëse për  
shpërndarjen e heroinës në Europë",  
shkruante Departamenti Amerikan i Shtetit në  
një raport në mars të këtij viti.

### NCA

Agjencia Kombëtare Britanike e Krimin (NCA)  
thotë se kërcënimin i grupeve kriminale shqiptare  
është domethënëse. "Londra është baza e tyre  
kryesore, megjithatë ata janë shpërndarë në të  
gjithë Mbretërinë e Bashkuar".

### RAPORTI

"Open Society" raporton se sektori i ndërtimit  
është kryesori, për të vazhduar më pas me  
kazinotë apo pikat e basteve. Aktivitetet e  
botës kriminale shqiptare kërcënojnë jo vetëm  
policinë ndërkombëtare dhe vëzhguesit e  
brendshëm në vend.

### SHKURTE

**Kultivimi i kanabisit,  
kapan tepelenasi dhe  
i riu nga Venezuela**

**GJIROKASTËR** - Një ditë pas  
asgjësimit të një mijë rrënjëve  
kanabis në Përmet, policia e  
Gjirokastrës ka vënë në pran-  
ga dy të rinj për kultivim dhe  
trafik droge. Mësohet se janë  
arrestuar në flagrancë sh-  
tetasi me iniciale V.M., 31  
vjeç, banues në fshatin Vëll-  
qot të Tepelenës si dhe A.M.,  
30 vjeç banues në Venezuelë.  
Policia nuk ka dhënë më  
shumë detaje rreth veprim-  
tarisë së paligjshme, për të  
cilën janë arrestuar dy të rin-  
jtë ose nëse është zbuluar  
ndonjë linjë e re trafiku me  
Shqipërisë dhe Amerikës Lat-  
ine. Ndërkaq, materialet i  
kanë kaluar Prokurorisë  
Gjirokastrë për veprat pe-  
nale: "Trafikim i narkotikëve"  
dhe "Kultivim i narkotikëve".

**Dhunimi i të dënuarit  
në burg, nis hetimi**

**për policët e dyshuar  
FUSHË KRUIJË** - Pas dyshi-  
meve se i dënuari Adriatik  
Lala është dhunuar nga  
punonjësit e policisë në bur-  
g e Fushë-Krujë, SHKBB  
ka nisur hetimin ndaj tyre, me  
urdhër të Ministrisë së  
Drejtesisë. Lajmi është kon-  
firmuar djepër "News24" nga  
Ministria e Drejtësisë. Ndër-  
kohë, që për ngjarjen e rëndë  
në burgun e Fushë-Krujë re-  
agoi edhe Komiteti i Helsin-  
kit. Dy ditë më parë u bë me  
dije se i dënuari Adriatik  
Lala kishte hematoma në  
kokë dhe në trup, ndërkohë  
që hetimi do të hedhë dritë  
mbi ngjarjen.

## Zjarri përfshin apartamentin, fqinji shpëton 83-vjeçaren e paralizuar

**DURRËS** - Një apartament  
në katin e katërt të një pa-  
lati në Durrës është përf-  
shirë dje nga flakët. Ngjar-  
ja ka ndodhur në lagjen nr.  
5 të qytetit bregdetar, tek-  
sa në apartament ndodhej e  
vetme një e moshuar e  
paralizuar. Kanë qenë fqin-  
jtë ata që kanë pikasur  
zjarrin dhe menjëherë  
kanë shkuar në ndihmë të  
83-vjeçares Mereme  
Shesho. Pasi kanë thyer  
derën e jashtme, fqinjtë  
kanë mundur të hyjnë në  
brendësi të apartamentit,  
duke e nxjerrë jashtë të  
moshuarën. Si pasojë e zjar-  
rit, gruaça ka marrë lën-  
dimë të lehta në njërin  
këmbë, ndërsa ndodhet



nën kujdesin e mjekëve në  
spitalin rajonal të Durrësit.  
Mësohet se ka mbetur i lën-  
duar edhe fqinji i së  
moshuarës, Ali Shehu, 62  
vjeç, i cili i dha asaj dhe ndi-  
hmën e pare. Ndërkaq, në  
vendngjarje kanë mbërri-  
tur efektivë të policisë si  
dhe forcat e zjarrfikësve, të  
cilët kanë bërë të mundur  
shuarjen e flakëve. Ende  
nuk dihen shkaqet e rënies  
së zjarrit, por policia po he-  
ton për të zbardhur rrethana-  
t e kësaj ngjarjeje.



Anëtarja e organizatës MEK: Nuk dua ta takoj Mostafa Mohammadin. Regjimi iranian komploton kundër nesh

# Somayah Mohammadi: Jam me muxhahedinët me dëshirë, s'jam peng 38-vjeçarja: Babai im agjent, pse i shkruajta Xhafajt

**K**ohët e fundit, një shtetas kanadez ka ardhur në Shqipëri për të takuar vajzën e tij, anëtare e organizatës së muxhahedinëve iranianë. Mostafa Mohammadi ka deklaruar në media se muxhahedinët, MEK, të cilët janë strehuar në Shqipëri, e kanë grabitur vajzën e tij dhe nuk e lejojnë ta takojë atë. 38-vjeçarja Somayah Mohammadi thotë në një intervistë për "GSH" se kjo nuk është e vërtetë dhe se ajo i është bashkuar MEK me dëshirë.

**Znj. Somayah, babai juaj, Mostafa Mohammadi, ka deklaruar në shtypin shqiptar se MEK ju ka mbajtur peng për 20 vjet dhe nuk ju lejon të takoheni me të?**

Kjo është krejtësisht një gënjeshtër qesharake. Sigurisht, unë nuk po e them këtë gjë vetëm sot, e kam thënë vazhdimisht gjatë viteve të shkuara se fjalët e Mostafa Mohammadit, nën pretekstin se është babai im, që thotë se jam mbajtur peng nga MEK dhe se nuk më kanë lejuar të takohem me të janë plotësisht gënjeshtër. Si mundet MEK të më ndalojë të takohem, sidomos ndërkohë që unë jam në Shqipëri, që është vend i lirë. Unë vendos për veten time. Jam 38 vjeçe. Ky është vendimi im, nuk kam ndërmend të takohem me njeriun që është agjent i Ministrisë së Inteligjencës së një regjimi vrasës. Kam zgjedhur të luftoj për lirinë e popullit të vendit tim, i cili është nën sundimin e një diktature mesjetare. Tani që po flas drejt me ju, jam e lumtur që mund t'u përgjigjem përsëri gënjeshtërave të këtij njeriu. Jam gjithashtu e lumtur që populli shqiptar do të dëgjojë fjalët e mia dhe të dijë të vërtetën.

**Pse thotë babai juaj fjalë të tilla për ju dhe pretendon se jeni mbajtur peng? Cili është qëllimi i tij?**

Nuk është vetëm Mostafa Mohammadi në lojë. Prapa kësaj gjëje fshihet regjimi iranian, edhe pse ai përpiqet të mos e tregojë veten. Qëllimi i regjimit iranian në këtë fushatë është të më keqpërdorë mua për të denigruar MEK. Për më tepër, unë nuk jam e vetmja; po të shihni mediat e regjimit iranian, në to thuhet se të gjithë njerëzit e komunitetit iranian në Manëz janë pengje të MEK. Kjo është një taktikë e përdorur nga të gjithë diktatorët për të denigruar opozitën e tyre demokratike. Ndërkohë që ishim në Irak, regjimi iranian mundi të keqpërdorte disa nga familjarët tanë, si tim atë dhe t'i vinte kundër MEK me kërcënime dhe rryshfete. Pas vizitave të tij tek unë nga 2002 në 2004 në kampin Ashraf në Irak, gjatë kthimit të tij për në Kanada, papritmas im atë i tha shtypit dhe autoriteteve kanadeze se MEK më kishte mbajtur me forcë në kampin Ashraf kundër vullnetit tim. Ky ishte fillimi i një lufte psikologjike që ai e filloi kundër meje dhe MEK, në emër të regjimit iranian. Qëllimi ishte të më bënte të dorëzohesha dhe të bashkëpunoja me regjimin iranian. Gjatë këtyre viteve, ai e ka përsëritur shpesh këtë gënjeshtër, në mënyrë që ta kthejë opinionin publik kundër MEK. Megjithatë, shumë herë, gjykata të ndryshme në Irak dhe Kanada kanë vendosur se pretendimet e tij janë të rreme. I kam të gjitha dokumentet. Gjithashtu, në Shqipëri kam bërë kallëzim kundër tij në polici dhe kam kërkuar që këto gënjeshtër të ndiqen nga procedurat ligjore.

**Në intervistat e tij, Mostafa Mohammadi ka thënë se nuk ka asnjë lidhje me regjimin iranian dhe se është thjesht një shtetas kanadez, që ka ardhur për t'ju parë juve. Pse thonë se ai është agjent i Ministrisë së Inteligjencës së Iranit?**

Është e ditur që Mostafa Mohammadi është agjent i Ministrisë së Inteligjencës së Iranit dhe këtë gjë e ka shpallur edhe ai vetë në shumë raste. Ai ka thënë se e ka për nder që është agjent i Ministrisë së Inteligjencës së Iranit dhe ka shumë dokumente që e vërtetojnë këtë. Në librin tim të titulluar "Fundi i një Komploti" i kam përmendur të gjitha, por ai po keqpërdor mungesën e informacionit të popullit shqiptar. Për më shumë se 15 vite ai më ka torturuar në



38-vjeçarja Somayah Mohammadi, duke folur për "GSH"

mënyra të ndryshme për të fituar para nga Ministria e Inteligjencës. Më lejoni ta shpjegoj këtë me një shembull, për informacionin tuaj, prania e agjentëve të Ministrisë së Inteligjencës së regjimit iranian rreth kampit Ashraf nën maskën e familjarëve hapirrugën për sulmet gjakatare dhe masakrat në kampin Ashraf, ku u vranë 141 banorë. Ata, përdorën 320 altoparlantë të fuqishëm për të bërtitur slogane kundër nesh 24 orë në ditë dhe në këtë mënyrë na vinin nën torturë psikologjike. Ata gjithashtu i nxinin agjentët irakenë për të sulmuar kampin Ashraf. Mostafa Mohammadi ishte gjithmonë i pranishëm dhe luante një rol kryesor në torturën psikologjike të banorëve të Ashraf. Përmes altoparlantëve, ai e shpallte herë pas here se është agjent i Ministrisë së Inteligjencës së Iranit dhe bënte thirrje për vrasjen dhe masakrimin e anëtarëve të MEK në kampin Ashraf. Do t'ju jap një klip të shkurtër të tij, teksa torturon banorët e Ashraf përmes altoparlantëve dhe kërkojë që ky klip të postohet në këtë intervistë. Do të citoj disa nga kërcënimet që ai dhe kolegët e tij thoshin shumë herë përmes altoparlantëve, që ta gjykoni vetë nëse ky është baba apo torturues:

**Mostafa Mohammadi: "Po i dhashë urdhër të sulmohen natën; a e dini se asnjëri prej jush nuk do të mbetet gjallë? Mos përhapni fjalën se kanë ardhur një numër mercenarësh. Në këmbë ardhur këtu me dokumente zyrtare. Dokumentet tona janë me udhëheqësit në Bagdad dhe me ashtarinë në Bagdad. Kjo e bërtitur që po bëj do t'ju kushtojë shtrenjtë një ditë. Ditën**

**që të lidh litarin rreth qafës së secilit prej jush dhe t'ju var. Rroftë Republika Islamike e Iranit!"**

Soraya Abdollahi, një agjente tjetër pranë Mostafa Mohammadi-t: "Dëgjoni këtu! Ky është fundi i rrugës... Do të jem prapa jush deri në sekondën e fundit. Do t'ju ndjek deri në sekondën e fundit. Unë, me duart e mia, me gishtat e mi, do ta fus në gojë tuaja dhe do t'ju shkul ato gjuhë të pista. Do të jem unë, ajo që do t'ju var. Do ta lidh vetë litarin rreth qafave tuaja... Do ta kthejmë Ashrafin në rrënoja... Do t'ju var secilin prej jush përpara Ashrafit. Do të bëjmë masakër dhe do ta shkatërojmë".

Ata vazhdonin ditë e natë me këto kërcënime për vrasje e djegie dhe Mostafa Mohammadi kishte rol kryesor në këtë gjë. Do t'ju jap gjithashtu edhe disa foto të altoparlantëve dhe do të doja t'i publikoni së bashku me intervistën, në mënyrë që populli shqiptar të bëhet i vetëdijshëm se si banorët e Ashraf për rreth dy vite ishin nën një torturë të tillë psikologjike dhe vrasje. Në vijim të kësaj torture psikologjike, e cila përgatiti terrenin për sulmet, shumë prej miqve të mi, duke përfshirë Asieh Rakhshani dhe Saba Haft Baradaran u vranë gjatë sulmeve. Prandaj siç thashë, kjo nuk është një çështje vizite familjare, por kërkesa që ata më të bëjnë mua është të dorëzohem para një regjimi kriminal, i cili ka vrarë miqtë e mi më të mirë.

**Ju i keni shkruar ministrit të Brendshëm, Xhafaj. A është prania e Mostafa Mohammadi kërcënim për ju?**

Siç kam shkruar në letrën time drejtuar ministrit të Brendshëm, prania e Mostafa Mohammadi në Shqipëri është alarmuese për mua. Nuk e kam për vete, por jam e shqetësuar për sigurinë e miqve të mi muxhahedinë në Shqipëri. Prania e tij tregon se regjimi iranian po planifikon të komplotojë dhe të bëjë djallëzi të tjera kundër nesh në Shqipëri. Kjo është sidomos e vërtetë, pasi kam dëgjuar se një nga agjentët më të rrezikshëm të Ministrisë së Inteligjencës së regjimit iranian me emrin Mostafa Roudaki është transferuar në ambasadën iraniane në Shqipëri. Kam dëgjuar gjithashtu se ky njeri ka qenë përgjegjës për operacione terroriste kundër anëtarëve të MEK në Europë. Nuk kam dyshim se si më përpara, ky regjim do të vazhdojë të komplotojë me denigrim në mënyrë që të dëmtojë sigurinë tonë dhe të shkelë të drejtën tonë për të jetuar. Do të përdorë propagandën të tillë si "MEK nuk lejon takim midis meje dhe Mostafa Mohammadi-t" apo se në moshehën 38-vjeçare, jam me MEK kundër vullnetit tim. Siç e shihni, në intervistat e tij me mediat shqiptare, ai pretendon në mënyrë patetike se muxhahedinët më kanë rrembyer dhe se unë jam me ta kundër vullnetit tim. Si dhe pretendime të tjera të tilla qesharake. Duke e sjellë Mostafa Mohammadin në Shqipëri, regjimi po përdor të njëjtat taktika që ka përdorur në Irak, në mënyrë që të sjellë

terrorizmin e tij këtu. Prania e Mostafa Mohammadi është për të përgatitur terrenin për këtë gjë. Pas arrestimit të diplomatit të regjimit iranian në Gjermani për organizimin dhe transferimin e eksplozivëve për bombardimin e tubimit të përvitshëm të rezistencës, e gjithë bota është tashmë dëshmitare e veprimtarive terroriste të regjimit. Për këtë arsye unë kërkoj që ministri i Brendshëm i Shqipërisë ta përfshijë Mostafa Mohammadin nga Shqipëria sa më shpejt të jetë e mundur dhe në këtë mënyrë të blokojë veprimtaritë e mëtejshme të regjimit iranian.

**Pse keni ardhur në Shqipëri dhe çfarë po bëni këtu?**

Unë erdha në Shqipëri në vitin 2016 nga Iraku përmes Kombeve të Bashkuara, pasi kur ishim në Irak, Iraku dhe qeveria e tij ishin nën ndikimin e regjimit të mullahëve. Si rezultat, vendbanimi ynë, kampi Ashraf dhe kampi Liberty ishin vazhdimisht nën sulmin nga forcat militante të qeverisë irakene, të cilat ishin të lidhura me regjimin iranian dhe forcat Quds. Në këto sulme u vranë 141 persona. Disa nga miqtë e mi më të mirë qenë midis të vrarëve. Me kërkësen e regjimit iranian, na vunë gjithashtu një bllokadë çnjerëzore (në Irak), sidomos bllokadë mjekësore. Nuk na lejonin as të vizitohejmë tek mjekët dhe kjo na kushtonte shtrenjtë. Për këtë arsye, 27

persona të tjerë humbën jetën për shkak të bllokadës mjekësore. Për këto arsye, Kongresi Amerikan, Parlamenti Europian si dhe Komiteti e Bashkuara filluan një fushatë ndërkombëtare, në mënyrë që ne të largoheshim nga Iraku. Fatmirësisht, populli i dashur shqiptar mori pjesë në të madhe të transferimit tonë, në krahasim me vendet e tjera europiane. Unë jam specialiste IT. Sigurisht, në Kanada kam bërë shkollën e mesme. Këtë specialitet e mora më vonë në një universitet që kishim në



Irak.

**Më lejoni t'ju bëj pyetjen e fundit. Prindërit tuaj thonë që nuk duan që tjetër veçe t'ju takojnë. Si i përgjigjeni kësaj?**

Ju lutem vendoseni veten në vendin tim. A jeni të gatshëm të takoheni me dikë që po bashkëpunon me torturim e njerëzve tuaj dhe merr pjesë në torturimin dhe vrasjen e tyre? Normalisht, asnjë person që e do lirinë dhe që është i përkushtuar ndaj vlerave njerëzore nuk do të donte të fliste me ta. Por, ai apo ajo do t'i dëbonte dhe demaskonte. Demaskimi është pjesë e demaskimit të armikut të popullit tënd. Unë kam folur ballë për ballë me ta në të shkuarën. U kam thënë që nuk dua t'i shoh më për shkak të bashkëpunimit të tyre me regjimin diktatorial të mullahëve, derisa ta ndalojnë këtë bashkëpunim. Fatqësisht, kjo nuk ka ndodhur dhe ata e kanë zgjeruar bashkëpunimin me regjimin çdo ditë e më shumë. Deri në atë pikë sa kanë ardhur tani në Shqipëri për të vazhduar misionin e tyre. Si rezultat, mendoj se çdokush do të më jepte të drejtën që të mos bëj takime të tilla që do të keqpërdoshin nga makineria e propagandës së regjimit iranian.

Plagosja e 38-vjeçarit pasditen e së shtunës, reagojnë familjarët: Ja si ndodhi ngjarja

Ina Allkanjari

# Përplasja me armë në Korçë, të afërmit e Hoxhallarit: Nuk kishte konflikte me autorin

Vjollca Muka: Nuk i detyrohej asgjë, ndodhej rastësisht në vendngjarje

Disa ditë pas ngjarjes së ndodhur në qytetin e Korçës, ku mbeti i plagosur me armë zjarri 38-vjeçari Erion Hoxhallari, të tjera detaje dalin në dritë. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", e afërmja e Hoxhallarit, shtetësja Vjollca Muka hedh poshtë dyshimet e ngritura lidhur me shkakun e përplasjes. Pas publikimeve se 38-vjeçari kishte konflikte të mëparshme me autorin Gazmend Agolli dhe se i detyrohej këtij të fundit shuma monetare, e afërmja e Hoxhallarit thekson se i riu ndodhej rastësisht në vendin e ngjarjes dhe se nuk i detyrohej asgjë Agolli. "Hedh poshtë dyshimet e ngritura lidhur me Erion Hoxhallarin përse i përket ngjarjes së ndodhur pasditen e 27 korrikut. Ditën kur ndodhi përplasja, Erioni bashkë me të birin po shkonin për në Pogradec dhe ndodheshin rastësisht në vendin ku ndodhi sulmi. Ai s'ka pasur konflikte të mëparshme me autorin dhe nuk i detyrohej asgjë", shprehet Muka, e afërmja e 39-vjeçarit Hoxhallari. Më tej ajo thekson se në momentin kur autori ka nxjerrë armë, Hoxhallari ka tentuar të ndalojë. "Erioni ka tentuar të ndalojë autorin që të mos të qëllojë me armë, duke u përpjekur t'i ulë armën që plumbat mos të kapin persona të tjerë, pasi zona ishte e populluar, në këtë mënyrë mbeti vetë i plagosur", u shpreh Muka. Në lidhje me këtë ngjarje policia vuri në pranga dy autorët e dyshuar: Gazmend Agolli, 49 vjeç dhe Daniel Morava, 43 vjeç, banues në Korçë. Uniformat blu bënë me dije se gjatë veprimeve hetimore të kryera u bë edhe arrestimi i shtetasit të plagosur Erion Hoxhallarit, 38 vjeç, banues në Korçë, pasi dyshohet se ka konsumuar elementet të veprës penale "Moskallëzimi i krimit" lidhur me këtë ngjarje. Ndërkohë, dy ditë më parë gjykata caktoi masën e sigurisë arrest me burg për 48-vjeçarin Gazmend Agolli, ndërsa për personin



Vendi ku ndodhi ngjarja

tjetër të përfshirë në konflikt, Daniel Morava, gjykata sipas kërkesës së prokurorisë, caktoi masën e sigurisë detyrim paraqitje. E njëjta masë siguri personale u dha edhe për Erjon Hoxhallarin, i cili mbeti i plagosur nga të shtënata e Gazmend Agolli.

**NGJARJA**

Një 38-vjeçar është plagosur me armë zjarri në qendër të qytetit të Korçës pasditen e së shtunës shumë pranë bashkisë, në lagjen numër 7, që është edhe një nga zonat më të frekuentuara të qytetit, ku ndodhen dhe shumë biznese. Konkretisht, një ish-punonjësi i policisë ka qëlluar me armë zjarri mbi 38-vjeçarin Erion Hoxhallari,

ndërsa ka tentuar të qëllojë edhe një person tjetër me iniciale A.Q., por ky i fundit iu ka shpëtuar plumbave. Policia e Korçës ka shkuar menjëherë në vendngjarje dhe ka vënë në pranga 49-vjeçarin Gazmend Agolli. Bëhet me dije se pas plagosjes, autori ka hedhur armën dhe është larguar me shpejtësi, ndërsa për të fshehur provat, shtetasi Daniel Morava ka larguar armën nga vendi i ngjarjes, por është ndaluar nga policia. "Arrestimi i tyre u bë pasi, në lagjen nr. 7, në rrugën 'Floresha Myteveli', dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta, shtetasi Gazmend Agolli ka plagosur me armë zjarri pistoletë shtetasin Eri-

**REAGIMI**

"Hedh poshtë dyshimet e ngritura lidhur me Erion Hoxhallarin përse i përket ngjarjes së ndodhur pasditen e 27 korrikut. Ditën kur ndodhi përplasja, Erioni bashkë me të birin po shkonin për në Pogradec dhe ndodheshin rastësisht në vendin ku ndodhi sulmi. Ai s'ka pasur konflikte të mëparshme me autorin dhe nuk i detyrohej asgjë", shprehet e afërmja e 39-vjeçarit Hoxhallari.

**Tritoli në banesën e Dacit, Vilson Brahaj: Nuk e dija që dy familje ishin në gjak, e bëra për para**

Gjykata e Tiranës vendosi ditën e djeshme masën e sigurisë "arrest me burg" për Vilson Brahaj, 23-vjeçari dyshohet se është autori i vendosjes së tritolit që shpërtheu në banesën e Gazmir Dacit, disa ditë më parë në Kamëz. Në seancën gjyqësore, Vilson Brahaj pranoi faktin se ishte ai, personi që vendosi tritolin, por nuk ka dhënë detaje se kush është porositësi. Gjithashtu, ai tregoi si ra në kontakt me personin që i kërkoi të vendoste tritolin dhe si e kreu veprimin. "Para tri-katër vitesh jam njohur me një djalë në Kamëz dhe e takova sërisht një javë më parë. Ai më kërkoi të gjeja një person për vendosjen e një sasive tritolin në një banesë po në Kamëz, kundrejt një sasive parash. Dhe unë pranova ta vendos vetë", ka rrëfyer ai. Por Brahaj ka shtuar se ndonëse shpërbli për këtë veprim do të ishte 5 mijë euro, ai mori paraprakisht vetëm 1500 euro. "Paratë e tjera nuk i mora. I kam rënë telefonit të tij të nesërmen e ngjarjes, por më ka dalë i fikur", u shpreh 23-vjeçari. Më tej, Brahaj tregoi se tritolin ia solli porositësi. "Duhet të shkohesh në shtëpinë e filanit dhe të vendosësh tritolin. E pyeta e kush është dhe më tha 'është shtëpia ime, se dua të largohem për azil'. Tritolin ma solli ai vetë dhe nuk e dija çdo ndodhte", tha Vilson Brahaj. Sakaq, ai ka deklaruar se veprimin e ka bërë për para, duke shtuar se nuk e dinte që dy familje ishin në hasmëri. "Nuk e dija që dy familje ishin në gjak", theksoi Brahaj. Deri më tani, e vetmja pistë është ajo e gjakmarrjes me familjen Kolaveri, edhe pse i arrestuari nuk ka dhënë emrin e porositësit. Pasi dëgjoji palët, gjykata vendosi "arrest me burg" për 23-vjeçarin Brahaj.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë, shirit plastik me numër identifikimi dhe letra fashetimi për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6.540.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë, shirit plastik me numër identifikimi dhe letra fashetimi për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **28 Gusht 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2.457.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje uniforme e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **04 Shtator 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Dokumentacioni i plotë që duhet të dorëzojnë studentët pranë sekretarive mësimore

# Udhëzimi, zbardhen datat e aplikimeve për transferim studimesh

## MASR: Kategoritë që nuk kanë të drejtë të kandidojnë

Voltiza Duro

Të gjithë ata kandi datë që dëshirojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi ose dëshirojnë të bëjnë transferim studimesh në një program të ciklit të parë, mund të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë në periudhën 3-14 shtator 2018-të. Datat janë zbardhur për të interesuarit nëpërmjet një udhëzimi nga Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, e cila thekson se kandidatët mund të aplikojnë deri në 5 programe studimi para fillimit të vitit akademik, duke iu përmbajtur afatave të përcaktuara. "Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo për transferim studimesh të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për programet e studimit për të cilët aplikojnë", - theksohet në udhëzimin e MASR. Ndërkohë, në këtë të fundit bëhet me dije se studentët që do të aplikojnë për programet e studimeve dyvjeçare profesionale nuk kanë detyrim që të plotësojnë kriterin e notës mesatare. Kandidatët duhet të kenë të qartë se nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit të ri akademik 2018-2019. Sakaq, në udhëzim theksohet se aplikimi për transferim studimesh mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël dhe lloj, të ndjekur nga studenti në IAL-të publike apo



### NOTA MESATARE

Ndërkohë, bëhet me dije se studentët që do të aplikojnë për programet e studimeve dyvjeçare profesionale nuk kanë detyrim që të plotësojnë kriterin e notës mesatare. Kandidatët duhet të kenë të qartë se nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit të ri akademik 2018-2019.

private të licencuara e të akredituara. Ndërkohë të gjithë ata kandidatët që rezultojnë ish-studentë të Institucioneve të Arsimit të Lartë të mbyllura për shkak të heqjes së licencës nuk mund të aplikojnë për

transferim studimesh. "Nuk mund të kryhen transferime studimesh nga një nivel cikli studimesh apo të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në një tjetër. Në këtë kuadër nuk mund të kryhen transfer-

### DOKUMENTET E KËRQUARA

- ◆ Një kërkesë drejtuar IAL për programin e studimit ku do të transferojë studimet.
- ◆ Një plan të plotë të programit të studimit.
- ◆ Një vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim i shlyer.
- ◆ Një fotokopje të dokumentit të identifikimit.
- ◆ Dy fotografi pasaporte.
- ◆ Kopjen e mandat pagesës.

\* Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacionin në IAL (pasi shpallet fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit për qëllim transferimi nga IAL nga ku po transferohet.

ime studimesh nga programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional në programe të ciklit të parë bachelor dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë master i shkencave", - nënvizohet në udhëzim. **DOKUMENTACIONI** Kandidatët që dëshirojnë të transferojnë studimet duhet të paraqesin pranë sekretarive mësimore dokumentacionin përkatës. Respektivisht ata duhet të dorëzojnë një kërkesë drejtuar IAL-së për programin e studimit ku do të transferojë stu-

dimet, një plan të plotë të programit të studimit si dhe një vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim i shlyer. Gjithashtu, duhet të dorëzojnë edhe një fotokopje të dokumentit të identifikimit, dy fotografi pasaporte dhe kopjen e mandat pagesës. "Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacionin në IAL (pasi shpallet fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit për qëllim transferimi nga IAL nga ku po transferohet.



**35 rrugë të reja në bllokun e banimit të Doganë**

Një vit më parë, blloku i banimit të zonës 'Doganës' i ngjante një zone lufte, ku kalimi në dimër ishte tejet i vështirë prej baltës dhe gropave të shumta. Por sot, banorët e kësaj lagjeje të re të kryeqytetit kanë një bllok të transformuar, me rrugë të rregulluara dhe hapësira të mjaftueshme, njësoj si në qendër të qytetit. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i shoqëruar nga kryetari i këshillit bashkiak, Aldrin Dalipi, inspektoi përfundimtar dhe punimeve për rikualifikimin e bllokut të banimit të 'Dogana', ku janë rehabilituar 35 segmente rrugore, duke përfshirë ndërtimin e infrastrukturës nëntokësore dhe shtrirjen e rrjetit të ri të ujësjellës kanalizimeve. "Jam shumë i lumtur që kthehemi pas një viti dhe në dallim nga hera e parë, me çizme e kambale, sot jemi në një situatë si dita me natën. Jo vetëm që infrastruktura këtu ishte e ngjashme me Kanadharin, por krijohet trafik, pluhur, baltë e llucë. Ndërkohë sot jo vetëm që s'ka trafik, sepse secili mbaron punë shpejt në rrugicën përkatëse, por kemi transformuar një bllok me 35 rrugë", tha Veliaj. Ai theksoi se tashmë është koha që edhe ata që kishin në dorë të bënin diçka për Tiranën dhe herë e bënë, të bashkëpunojnë përtej bindjeve politike, për vendime të rëndësishme për qytetin. "Unë e kuptoj se jo të gjithë dëshirojnë dashuri për qytetin. Ka disa që nuk u vjen mirë pse qytetit po i shkojnë punët mbarë, megjithatë them se është mirë edhe për ata. Një qytet që funksionon, një qytet që është i pastër, një qytet ku njerëzit e duan njerëzrin, është mirë edhe për ata. Edhe për ata që e kishin në dorë dhe mund ta kishin ndryshuar Tiranën, por humbën një shans për ta bërë dhe do të duhet që tani të bashkëpunojmë të gjithë, përtej të majtës dhe të djathtës, për vendime të rëndësishme për qytetin", theksoi Veliaj.

## Klosi, thirrje bizneseve: Kujdes, mos abuzoni me çmimet!

Kontrollet për minimin e abuzimeve me çmimet nga bizneset pranë zonave turistike do të vazhdojnë. Ky është paralajmërimi që ka bërë ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, gjatë takimit të djeshëm me përfaqësues të bizneseve turistike të Velipojës, drejtorët racionalë dhe anëtarët e Komitetit të Turizmit. "Shteti do të jetë në kontroll që aktiviteti të mos jetë abuziv, të keni në kujdes problematikat e lindura tashmë edhe nga dashakeqës të turizmit në Shqipëri për rritjen e çmimeve, abuzimet me çmimet, prandaj do t'ju



kërkojmë në radhë të parë juve që keni bizneset në këto zona që të jeni shumë më transparentë me pushuesit, të keni në çdo restorant apo hotel, lista

çmimesh të afishuara dhe biseda me turistët të jetë direkte, e sqaruar, përsa u përket çmimeve dhe do të vazhdojnë kontrollet përsa i përket ligjit, pasi unë mendoj që një dhe vetëm një është çelësi i suksesit, zbatimi i rregullave nga të gjithë", - tha ministri Klosi. Më tej, ky i fundit theksoi se është arritje, ngritja e kullave të vrojtimit dhe angazhimi i 250 vrojtuesve duke minimizuar jetën e humbura në det, por ministri u bëri thirrje bizneseve se është detyrimi i tyre ligjor për vënien e rojeve të certifikuara.

## Nis rikonstruktimi i Dispanserisë, investim edhe në pajisje

Ka nisur rikonstruktimi i klinikës së specializuar për sëmundjet e mushkërive në Tiranë e njohur



ndryshe si Dispanseria. Ditën e djeshme ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu inspektoi nga afër punimet dhe theksoi rëndësinë e këtij investimi. "Kemi hapur investime madhore në shëndetësi dhe padyshim programi kombëtar për rindërtimin e 80 qendrave shëndetësore është ndër më të rëndësishmit që ka nisur e zbatohet këtë vit. Pjesë e këtij programi është investimi tek Dispanseria, e cila do të rindërtohet dhe do të pajiset me aparaturë moderne për t'ju shërbyer rreth 40 mijë pacientëve që marrin shërbim të specializuar në këtë qendër", tha Manastirliu. Sipas ministres, janë 14 qendra shëndetësore në qarkun e Tiranës që po rikonstruktohen me buxhetin e shtetit vetëm gjatë këtij viti.

Në flakë pjesa jugperëndimore e Europës, ja shifrat alarmante që u regjistruan

# Vjen i nxehti afrikan, priten temperatura deri 48°C

Vera e 'zjarrtë', pasojë e qartë e ngrohjes globale

Meteorologët parashikojnë që pjesë të Europës të kapin shifra rekord, duke shënuar temperaturat më të larta të gjitha kohërave. Ekspertët parashikojnë që në disa pjesë të Spanjës dhe Portugalisë temperaturat të variojnë nga 40 deri në 48 gradë celsius në ditët në vijim. Pjesë të jugperëndimit të Francës pritet gjithashtu që të preken nga vala e të nxehtit ekstrem, ashtu sikurse edhe në Britaninë e Madhe. Të dhënat bënë që autoritetet spanjolle të lëshojnë alarmin e parë për 2018-n. Ata i bënë thirrje banorëve që të qëndrojnë larg diellit dhe të pinë sa më shumë ujë. Pritet që 27 nga 50 provinca në vend të preken nga i nxehti ekstrem, duke nisur nga e enjtja. "Temperaturat nëpër Iberi mund të thyjnë rekordin e të gjitha kohërave në Kontinentin Europian, duke shkuar në 48 gradë Celcius", tha në një postim në "Twitter", Zyra Meteorologjike. Autoritetet portugeze kanë mobilizuar 11 mijë vullnetarë zjarrfikës, policë dhe ushtarë për të kontrolluar operacionet në një situatë të mundshme zjarri. Lajmi i mirë është që pas ditës së diel temperaturat pritet të ulen. Edhe autoritetet në Shqipëri kanë paralajmëruar një javë të nxehtë, me temperatura mbi 36°C thuasë në të gjithë ultësirën perëndimore. Në zona specifike, pritet që temperaturat të ngjiten në 39°C. Shqipëria do të mbetet në periferi të valës së të nxehtit afrikan, njofton "Meteoalb", valë që gjatë mesditave të kësaj fundjave, sjell temperatura mbi 30°C në 90% të territorit shqiptar. Në zonat malore temperaturat maksimale variojnë nga 31 në juglindje deri 35°C zonat verilindore



si Kukësi; në bregdet dhe zonat e ulëta temperaturat maksimale ngjiten në 35 - 36°C por në zona specifike pritet që temperaturat maksimale të ngjiten lehtësisht mbi 38°C. Sipas "Meteoalb", në zona specifike, pritet që temperaturat të ngjiten në 39°C (Shkodra, Berat dhe rrethinat e tyre). Përsa i përket shirave, parashikohet që 10-ditëshi i parë të jetë kryesisht i thatë, shirat më të pranishëm në formën e stuhive të izoluara në zonat malore ndërësa në dt. 2 - 3 gusht rresbeshe afatshkurtra rrezikojnë zonat Qendrore

dhe Jugore. Ndërkaq vera e temperaturave ekstreme vazhdon me valë të nxehti rekord, këtë muaj, në të katër kontinentet e hemisferës veriore jo tropikale. Të hënën e 23 korrikut, Japonia, regjistroi një temperaturë që asnjëherë më parë nuk ishte arritur në vendin ishull që kur regjistrimi i të dhënave filloi në vitet 1800. Kumagaja, një qytet në veri të Tokios, regjistroi 41.1 gradë celsius në mesin e një vale të nxehti disajvëshe që ka shkakuar edhe shumë viktima. Temperatura ekstreme po

prekin edhe vende të tjera në Azinë lindore; Koreja e Jugut dhe ajo e Veriut kanë regjistruar temperatura rekord prej afër 40 gradësh celsius. Dhe pikërisht për këtë lloj vale të nxehti kanë paralajmëruar shkencëtarët, kur i binin kambanave të alarmit për ngrohjen e planetit përmes emetimeve të gazrave që shkaktojnë efektin serë. "Pasojat e ndryshimeve klimatike, nuk janë më të padukshme", thonë shkencëtarët, "ne po i shohim ato në kohë reale, në formën e valëve të paprecedentë të

të nxehtit, përmblyetje, thatësirave dhe zjarreve masive. Pjesa më e madhe e Evropës është mbërthyer nga një valë masive presioni të lartë që mundëson të nxehtin tropikal të mbërrijë deri në arktik. Temperaturat mbi 32 gradë celsius janë shtrirë deri në brigjet veriore të Skandinavisë, duke shënuar rekorde në Suedi, Finlandë dhe Norvegji, në stacionet mbi rrethin arktik. Si rezultat, janë verifikuar zjarre të paprecedenta në Suedi që kanë bërë që ajo të kërkojë ndihmë nga vende të tjera, si Italia, me më shumë burime për të luftuar zjarret. Britania e Madhe po ashtu ka përjetuar verën më të thatë të saj dhe më të nxehtën po ashtu. Në shkretëtirën e Saharasë, në Afrikën Veriore, më 5 korrik u regjistrua rekordi i të gjitha kohërave, 51.3 gradë celsius, dhe kjo ndodhi në Ourgla të Algerisë. Një valë të nxehti ekstrem goditi edhe Kanadanë këtë muaj, me të paktën 70 viktima në Kebeq. Ndërsa në SHBA, i nxehti i korrikut është shtrirë nga veri-lindja deri në jug-perëndim. Ftohtë dhe nxehtë, lagështirë apo thatësi, ne i përjetojmë kushtet natyrore të motit gjithë kohën, por ndryshimet klimatike po kthejnë tani gishtin kundër nesh, duke bërë që disa lloj ekstremesh të jenë më të shpeshta dhe më intensive.

## SHKURT

### Ndalohen telefonat dhe tabletat në shkollë

Nxënësit në Francë e kanë të ndaluar të përdorin telefonat celularë gjatë orëve të mësimit. Parlamenti francez miratoi ligjin për ndalimin e tyre në shkollat fillore dhe të ciklit të dytë, por për gjimnazet telefonat celularë do të lejohen. Ndalmi përfshin çdo aparat që mund të lidhet me internetin, si telefon, tablet, apo edhe orë. Në ligj nuk përfshihen mësuesit. Ata mund të përdorin këto aparatura për qëllime pedagogjike. Ministri i arsimit Jean-Michel Blanquer, sqaroi se drejtuesit e shkollave do të mundësojnë vendosjen e sirtarëve të posaçëm në hyrje të klasave, për vendosjen e pajisjeve teknologjike. Largimi i nxënësve deri në moshën 15 vjeç nga teknologjia e telefonave, ishte një nga premtimet elektorale të presidentit Emmanuel Macron. Deputetët e "La République en Marche", partisë së presidentit votuan pro ligjit që ka ngjallur debat në Francë. Për Republikanët opozitarë ligji nuk është gjë tjetër veçse një nismë për dukje dhe që nuk mund të zbatohet në terren.

### Parandalohet sulmi terrorist

Forcat antiterrorist në Egjipt parandaluan një atentat terrorist, duke shkatërruar një celulë që po përgatitej të sulmonte disa zona të populluara me qëllim destabilizimin e vendit. 5 militarë të organizatës "Vl-zëria Myslimane" u ranë nga forcat egjiptiane në një provincë pranë kryeqytetit Kajro, ndërësa 5 të tjerë u arrestuan. Autoritetet egjiptiane e konsiderojnë si terrorist këtë organizatë. Ky grup akuzohet gjithashtu për një sërë sulmesh ndaj forcave të sigurisë dhe institucioneve shtetërore.

### Politikani serb bën

### "shqiponjën" në televizion

Gjesti i bërjes së shqiponjes me duar gjithmonë ka ngjallur reagimin e serbëve, por jo të politikantit liberal Qedomir Jovanović. Gjatë një interviste në televizionin N1 ai ka bërë "shqiponjën", duke u shprehur se reagimet negative ndaj situatës tilla, i ka penguar serbët të ecin përpara. Jovanović thotë se "shqiponja" është një simbol kombëtar për shqiptarët, ashtu siç janë për serbët "tre gishtat". Sakaq, politikani liberal serb ka kritikuar politikën dhe shoqërinë serbe, që sipas tij e kanë lënë vendin mbrrapa, duke u marrë me gjëra, siç i quan ai, "të qmëndura". Së fundmi, Jovanović ka nisur një iniciativë në Serbi, për të krijuar një "Koalicion të Paqes", përmes të cilit do të kërkohej arritja e një marrëveshjeje paqësore në mes të Serbisë dhe Kosovës, gjë që sipas tij, do t'i hapte perspektivë integrimit të Serbisë.

## Mbi 6.000 produkte, sa do të jetë taksë ndaj mallrave aziatike

### Përkallëzohet me tej lufta tregtare SHBA-Kinë, paralajmërohen tarifave e reja

Përkallëzohet me tej lufta tregtare mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës. Sipas mediave amerikane, paralajmërohet vendosja e tarifave të reja ndaj mallrave të gjigantit aziatik, por ndryshe nga ç'ishte parashikuar, tarifa ndaj mallrave me vlerë 200 miliardë dollarë do të jetë 25 për qind, dhe jo 10%. Plani mund të njoftohet brenda kësaj të mërkure, por një burim i mediave amerikane thotë se tarifa më e lartë nuk është finalizuar ende. Kjo do të rrezikonte një përkallëzim të mëtejshëm të tensioneve mes SHBA-ve dhe

Kinës, të cilat edhe kështu siç janë duket se po zhvillojnë një luftë të ashpër tregtare. Në korrik, Shtetet e Bashkuara publikuan një listë me produkte shtesë kineze, me vlerë 200 mld dollarë, të cilat do të tarifoheshin jo më vonë sesa fillimi i shtatorit. Në listë ka mbi 6.000 produkte, duke nisur nga artikuj ushqimorë, minerale dhe mallra të tjerë konsumi, si çantat e dorës. Presidentin Donald Trump ka thënë se është gati të vendosë tarifa ndaj të gjitha importeve kineze, me vlerë 500 miliardë dollarë. SHBA akuzon Kinën për vjedhje të të drejtave intele-



ktuale, ndaj kërkon të ulë deficitin e lartë me ekonominë e dytë më të madhe të

botës. Por, mosmarrëveshjet tregtare shihen gjithashtu si pjesë e një lufte më të gjerë

**MEDIAT AMERIKANE** Paralajmërohet vendosja e tarifave të reja ndaj mallrave të gjigantit aziatik, por ndryshe nga ç'ishte parashikuar, tarifa ndaj mallrave me vlerë 200 miliardë dollarë do të jetë 25 për qind, dhe jo 10%. Plani mund të njoftohet brenda kësaj të mërkure, por një burim i mediave amerikane thotë se tarifa më e lartë nuk është finalizuar ende.

mes dy superfuqive për më shumë ndikim në arenën ndërkombëtare.

SHTATË SHENJA QË ZBULOJNË QË JENI HELMUAR ME USHQIM DHE PËR CILIN USHQIM ËSHTË FJALA

# SUMMER

*pages*

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E enjte 2 Gushi 2018



**Anna Lika ul bluzën dhe del topless**



**Alketa Vejsiu, e mrekullueshme me bikini**

**BULEVARDI POLITIK**



- Kryeministri Rama nis pushimet, kafe e libra buzë detit
- Gjikhuri dhe Hyseni të veshur sportivë, vizitojnë bizneset në Sarandë e Ksamil
- Dorëzoi mandatin e deputetit, Tahiri provon të bëjë DJ-n në klubet e natës
- Presidenti Meta bën simbolin e shqiponjës dhe i "bie" çiftelisë

Relaxhet sopranoja: Si u ndjeva në Korenë e Veriut dhe turi nacional

**HERSI MATMUJA:**  
**Nuk e vë kurrë veten para muzikës**

*"Italianët thonë erdhi gjenerali"*

**Grëfhet sopranoja: Si u ndjeva në Korenë e Veriut dhe turi nacional**

# Hersi Matmuja:

## Nuk e vë kurrë veten para muzikës

*"Italianët thonë erdhi gjenerali"*

Egla Xhemali

**B**ota e muzikës ndahet mes pasionit, talentit dhe sakrificës për të punuar fort e për t'ia dalë mbanë. Në këtë udhë ka kaluar një nga zërat e rinj shqiptar, që tanimë ka debutuar në tregun ndërkombëtar. Hersi Matmuja. Sopranoja ndan me suplementin "Summer Pages" hapat e parë të shkollimit të saj në Itali, vështirësitë që ka hasur atje, mënyrën se si e etiketojnë italianët për karakterin, talentin dhe natyrën që ka, eksperiencën e mësimdhënies në Korenë e veriut, për pjesëmarrjen në "Festivalin e Kinemasë" së Venecias, si dhe për turin nacional e inter-nacional me operën "Don Giovanni" me Orchestrën e Piazza Vittorio. Hersi na thotë se për gjithçka i është mirënjohëse familjes. Një nga eksperiencat më të veçanta që ka kaluar është ajo e Koresë së Veriut, ku na tregon se e respektonin figurën e mësimdhënësit. Më tej sopranoja na thotë se kur i fik "motorët", bën vetëm plazh dhe se kur është e qetë me veten, mund të prekë parajsën, kudo që ndodhet. Në fillim të shtatorit Hersi pohon se do të jetë në Shqipëri me operën "Kater i Radës", ku do të japë tri shfaqje në Shkodër, Prishtinë e Tiranë. Ne urojmë që sopranoja na prijë e mbara dhe të ketë sa më shumë arritje profesionale!

**Cila ka qenë dalja publike që ju bëri më shumë të njohur?**

Së pari, faleminderit për intervistën! Me siguri dalja publike që më dha më shumë shikueshmëri ishte fitorja në Festivalin e Këngës në RTSH, në vitin 2013.

**Keni studiuar në Itali, cila ka qenë vështirësia e parë kur nisët jetën atje?**

Jetoj në Itali që prej vitit 2009. Vështirësitë e fillimit janë sa të pae-vitueshme, por aq edhe të nevojshme për t'u rritur e maturuar. Nuk është e thjeshtë të fillosh nga e para në një



vend të huaj, me gjuhë të huaj, me zakone e mënyrë të menduarit krejt tjetër nga ç'isha mësuar. Por, ka qenë hapi më i zgjuar dhe i guximshëm që kam bërë dhe isha vetëm 19 vjeçe. Një hap i tillë është përgjegjësi e madhe, sidomos kur shtojmë faktorin moshë (një vajzë 19-vjeçare e sapo dalë nga Liceu Artistik). Por, guximi dhe dëshira për të realizuar ëndrrat kontribuan në stimulimin dhe forcën për të përballuar një realitet krejt të ri. Studimet në konservatorin e San-

ta Cecilia-s të Romës kanë qenë sa të vështira, aq edhe të bukura, me aventura e me shumë njohje artistike të rëndësishme. Kanë qenë vite që unë kurrë nuk do t'i harroj.

**Çfarë i bën artistët shqiptarë të vlerësohen shumë nëpër botë?**

Përtej talentit e zërit, me etiketojnë si karakter të fortë e që nuk dorëzohem kollaj. Disa më thonë "Erdhi gjenerali", kështu thonë... E vërteta është se nuk të jepen shpesh mundësi të dyta e duhet të gjendesh gjithmonë gati kur është momenti y. Duhet vullnet i fortë të zgjohesh çdo ditë e të studiosh, pavarësisht impenjimit (ke apo jo koncert atë ditë). Duhet shumë punë e studim, nuk mjafton talenti për të qenë një këngëtar/e i/e mirë. Studimi e përmirësimi është pjesë kyçe, fundamentale. Mendoj që në fillim, fakti i të qenurit i/e huaj nuk të favorizon plotësisht, kështu që puna është e dyfishtë. Gabimet nuk janë një opsion i pranueshëm, ose të paktën kështu e kam menduar unë. Dhe së fundmi, të gjitha vështirësitë artistike duhet t'u shtoj dhe ato ekonomike që nuk janë aspak për t'u anashkaluar. Këtu, në këtë pikë, më duhet të falënderoj familjen time që më ka lejuar të jem këngëtare. Kur gjendem në teatër duke kënduar ose

në ndonjë shtet që kurrë nuk do kisha menduar të këndoja, shpesh ndalohe, e mendoj nga kam ardhur. **Eksperienca juaj në Kore. Çfarë ju tërhoqi më shumë vëmendjen atje?** Eh "Kore" duhet t'i shtosh "e Veriut", sepse nuk është e njëjta gjë e nuk i referohem ndryshimit emëror (qesh) Atëherë, në Korenë e Veriut kam dhënë mësim një muaj si pedagoge e dërguar nga konservatorin Santa Cecilia. Ka qenë një eksperiencë shumë unike dhe pa çka vështirësive që mbart kjo e fundit si vend. Pa internet e lidhje me botën ku jetoj çdo ditë. Ka qenë interesante për mua puna teknike e zhvilluar me studentët dhe profesorët e konservatorit të Pyongyagut. Dukej sikur koha ishte ndaluar. Por, nga ana tjetër kam gjetur një mirëpritje shumë të ngrohtë e një respekt për figurën e mësuesit, që perëndimi e ka humbur me kohë.

**Për çfarë mendoni se kanë nevojë më shumë studentët e kantos në Shqipëri?**

Shkolla kudo që të jetë të jep një formim të përgjithshëm. Është detyrë e studentit të kërkojë stimuj e si rrjedhojë të stimulojnë dhe profesorët për të ofruar më shumë se standardi i përcaktuar nga programi arsimor. Nuk më kanë pëlqyer kurrë "të parët e klasës" në sensin e mirë. Unë kam studiuar me këngëtarë të famshëm e jo të famshëm dhe nuk kam lejuar që akush

të jetë pronar i mendimeve të mia, pra në brendësinë time nuk kanë depërtuar, origjinaliteti dhe personaliteti im muzikor ka mbetur gjithmonë i paprekur. Një mësues i madh nuk të imponon, por të ndihmon të zbulosh mënyrën tënde të të kënduarit. Nuk është për të gjithë njëloj. Shkolla si institucion është njëloj e rëndësishme kudo qoftë, në Itali o Shqipëri, është studentit ai që zbulon identitetin e tij në realitetin ku jeton. Një gjë e rëndësishme për mua është të mos vë kurrë veten para muzikës. Për këngëtarët është pak e vështirë ky koncept.

**Çfarë nuk dimë ende për jetën tuaj private?**

He he he kurioze... Jeta private është private.

**Kur i fikni "motorët" në verë, çfarë bëni?**

Plazh, plazh, plazh.

**Cili është ushqimi që nuk ju merrtë kurrë dhe pse?**

Realisht çdo gjë kur e ha shumë të merrtë, por unë me të kripurat kam raport shumë të mirë.

**Kush është njeriu që arrin të t'ia prishë mendjen direkt për diçka?**

Eh, i fejuari im normale.

**Një vend që ju bën të preknë para-sën dhe pse kjo zgjedhje?**

Nëse jam e qetë dhe mirë me veten, mund të prekë parajsën, kudo që ndodhem.

**Në cilën skenë do ju shohim tani?**

Po afrohet "Festivali i Kinemasë" i Venecias, ku së bashku me Mesimër Ensemble do të luajmë muzikë "live" (direkt) origjinale të kompozuar nga kompozitori Admir Shkurtaj më 28 gusht, në natën e inaugurimit të festivalit të Kinemasë së Venecias. Aty do të bëjmë "live", një nga klasikat e kinematografisë pa zë "Il Golem" të Paul Wegener. Më pas, në fillim shtatorit do të jem në Shqipëri me operën "Kater i Radës". "Il Naufragio" kompozuar nga Admir Shkurtaj me bashkëprodhim të "Teatrit Koreja e Biennale Musica di Venezia". Do të japim tri shfaqje në Shkodër, Prishtinë e Tiranë. Më pas, më pret një tur nacional e internacional me operën "Don Giovanni" me Orchestrën e Piazza Vittorio. Ky tur do të përfshijë muajt e fundit të 2018-ës e gjysmën e 2019. Shpresoj e besoj, që do të jenë muaj shumë intensiv e me sodifikacione profesionale.




## Anna Lika ul bluzën dhe del topless

**M**e gjithë këtë vapë i japim deri diku të drejtë. Aktorja Anna Lika ka provokuar sërish. Ajo ka ndarë në rrjetet sociale një foto mjaft pikante. Anna ka qenë mjaft aktive me postimet në "Instagram", ku ka ndarë me të gjithë fansat momente nga më të bukura të këtyre ditëve të nxehta. Edhe këtë herë nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Bukuroshja ka ulur bluzën për të nxjerrë gjoksin. Dhe meqë kohët e fundit shalqiri është shumë në modë, Anna ka pozuar me të. Gjithmonë aktorese i vijnë ide të "çmendura" në kokë.



## Alketa Vejsiu, e mrekullueshme me bikini

**M**oderatorja e njohur Alketa Vejsiu duket se nuk i ka përfunduar ende pushimet. Këtë herë ajo ka zgjedhur jugun e Shqipërisë, nga ku ka publikuar disa foto në rrjetet sociale duke treguar bukuritë e natyrës shqiptare. Jo të rralla kanë qenë fotot nga deti, që ka publikuar moderatorja. Së fundmi, ajo ka ndarë me të gjithë fansat në "Instagram" një foto me bikini, ku e shohim më në formë se kurrë dhe me linja mjaft të kuruara.



## Anxhela Martini "çmend" ndjekësit

**A**nxhela Martini është një nga personazhet më të komentuar të 'show bizz'-it shqiptar. Bukuroshja tanimë u është larguar impenjimeve për t'u relaksuar në këto ditë të nxehta vere. Ajo ka qenë mjaft aktive në rrjetet sociale kohët e fundit, ku ka ndarë me të gjithë foto nga vendet që po viziton. Së fundmi, Anxhela ka publikuar dy foto në të cilat duket mjaft "hot" veshur me një kanotiere me dantellë, në të cilën bien në sy format bombastike të modeles. Nuk kanë qenë të pakta komentet komplimentuese që ka marrë bukuroshja.



## Einxhel Shkira, më provokuese se kurrë

**E**inxhel Shkira njihet për postimet e saj provokuese. Nuk kishte si të mungonte edhe këtë herë një foto në të cilën ajo shfaqet tejet përvëluese me bikini dhe xhinse mjaft të shkurtra. Bukuroshja është duke shijuar këto ditë të nxehta vere në Mykonos, ku duket se po kënaqet shumë. Ajo që bie në sy është trupi perfekt i saj, që është përkëdhelur nga rrezet e diellit.



**N**ëse hani ushqim jo mjaft të pjekur, mund të fusni në organizëm një numër të madh bakteresh, virusesh dhe parazitësh, që shkaktojnë kaos në organizëm. Nuk është fjala vetëm për llojet e ushqimeve të cilat i gatvani, por edhe temperatura, mënyra e gatimit dhe si i ruani pas gatimit. Simptomat e helmimit me ushqim, varen nga ajo se me çfarë është infektuar ushqimi. Në kategorinë e rrezikuar bëjnë pjesë femijët, të moshuarit, ata me imunitet të dobët, por edhe ata me sëmundje kronike. Secili mund të jetë i rrezikuar nga helmimi me ushqim. Këto janë vetëm disa nga simptomat: humbja e apetitit, ngërçet në stomak, të vjellët, diarreja, temperatura, lodhja dhe dehidratimi. Shkaktar i shpeshtë janë sallatat dhe pastat, sepse nuk ruhen në temperaturë të përshtatshme. E rëndësishme është që ushqimin e ngrohtë ta mbani të ngrohtë, ndërkaq të ftohtin të ftohtë. Ushqimin që priset mbajeni jashtë frigoriferit vetëm dy orë, apo një orë, varësisht nga temperatura. Mishin e pulës pas gatimit mos e nxirrni në të njëjtën pjatë në të cilën ka qenë edhe para pjekjes. Kështu mund të infektoheni me *Escherichia coli*. Kujdes me ujën kur e blini në ndonjë vend të ri. Kush-toni kujdes cili ujë është i pijshëm dhe patjetër ta blini të paketuar në shishe. Mbani me vete probiotikë, sepse në udhëtime shpesh ndodh çrregullimi i nivelit të baktereve në zorrë. Është i rrezikshëm edhe ushqimi të cilin e ngrohni, madje edhe nëse ka qenë i gatuar në mënyrë të drejtë dhe i vendosur në frigorifer. Ushqimi në frigorifer mund të grumbullojë ndonjë nga bakteret dhe kur nuk e ngrohni mjaftueshëm, ato mbeten në ushqim. Shumica e rasteve të helmimeve janë të lehta dhe kalojnë pas disa ditësh. Marja e lëngjeve në sasi të mëdha, buka e gatuar për tost, pushimi mund të bëjnë që helmimi shpejt të kalojë. Nëse nuk mund të mbani lëngjet në organizëm dhe në jashtëqitje keni gjak, ndieni dobësim të muskujve dhe keni shikim të mjegulluar, keni diarje e cila zgjat më shumë se tri ditë patjetër shkoni te mjeku. Në atë rast, helmimi juaj mund të komplikohet dhe të përkeqësohet.



## Shtatë shenja që zbulojnë që jeni helmuar me ushqim dhe për cilin ushqim është fjala

*Ushqimi të cilin e keni ngrënë mund të shndërrohet shumë shpejt në ankthin tuaj, nëse nuk është gatuar në mënyrën e duhur.*





## Kryeministri Ramanis pushimet, kafe e libra buzë detit

**E** paralajmëroi një ditë më parë në konferencën e fundit me koordinatorët për bashkëqeverisjen, ndërsa dje kryeministri Rama duket se nuk ka humbur kohë. Kreu i qeverisë ka nisur pushimet, ndërsa ka postuar në "Insta story"-n e tij një video të shkurtër, ku shfaqet buzë detit duke pirë kafe, ndërsa në filxhan është i stampuar simboli kombëtar. Shoqëruesi më i mirë në kafën e mëngjesit për kryeministrin, të cilin ka dashur ta ndajë me ndjekësit e tij duket se është libri, ku lexohet një shprehje e veçar nga David Ogilvy "Idetë e mëdha vijnë nga e pandërgjegjshmja. Por, e pandërgjegjshmja juaj duhet të jetë informuar mirë, ose ideja jote nuk do të ketë kuptim". Një rastësi kjo e kryeministrin në shfletimin e librit, apo një mesazh edhe në ditë pushimesh...



## Gjiknuri dhe Hyseni të veshur sportivë, vizitojnë bizneset në Sarandë e Ksamil

**M**inistri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, i shoqëruar nga deputeti i zonës, Alket Hyseni vizituan disa biznese të reja hotele-rie në Sarandë dhe Ksamil. "Patëm rastin të vizitojmë dhe shohim nga afër disa biznese hotele-rie, që janë hapur së fundi në Sarandë dhe Ksamil. Patëm mundësinë që të bisedojmë edhe me personat që operojnë këto biznese, por edhe me operatorët që kanë sjellë turistë nga Polonia apo vende tjera që vizitojnë Sarandën. Qeveria shqiptare po investon në të gjitha zonat bregdetare për të mbështetur turizmin, por njëkohësisht fluksi sa vjen dhe rritet në turizëm", u shpreh Gjiknuri. Sipas tij, gjatë bashkëbisedimit me operatorët është diskutuar edhe nevoja për një konektivitet më të mirë, sidomos me Korfuzin.



# BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊



## Dorëzoi mandatin e deputetit, Tahiri provon të bëjë DJ-n në klubet e natës

**S**aimir Tahiri duket se po i shijon në maksimum ditët e tij në liri, edhe pse çështjet me drejtësinë i ka ende të hapura. Ai është fotografuar duke bërë rolin e DJ në një prej bareve të Tiranës. Ish-ministri i Brendshëm është shfaqur tepër sportiv, me një t-shirt dhe me xhinse, e nuk ka nguruar të provojë çdo gjë të re që i është dukur interesante. Kujtojmë se dje, ai u paraqit pranë ambienteve të Kuvendit, ku u mbajtën homazhet për të ndjerin Luan Hajdaraga. Tahiri duket se po ndjek trendet e fundit të modës në botë, pasi ndryshe nga kur ishte ministër, tashmë është vënë re rritja e mjekrës, e cila e bën edhe më hijerëndë.



## Presidenti Meta bën simbolin e shqiptonjës dhe i "bie" çiftelisë

**K**ëto ditë të nxehta Presidenti Ilir Meta ka zgjedhur që t'i kalojë mes natyrës, ndërsa ka vizitën e tij në Malin e Zi, në Plavë e Guci. Presidenti u përshëndetë përzemërsisht nga organizatorët edhe të Festivalit Folklorik Kombëtar "Kënga dhe vallja shqipe na bashkoj". Mes fotove që ka publikuar Presidenca, shihet teksa Meta bën shqiptonjë, apo pozon duke i rënë çiftelisë. Meta u nderua nga drejtuesit dhe organizatorët e Festivalit Folklorik Kombëtar si dhe nga Shoqata "Krenaria e Alpeve shqiptare" me titullin e veçantë vlerësues e simbolik "Mirënjohje" për "Demokratizimin dhe integrimin e shqiptarëve në rajon".



Voltiza Duro

Procedura që duhet ndjekur. Sa do të jetë sipërfaqja e tokës që do të marrë çdo familje

Lista me 619 personat që kanë gati lejet e legalizimeve

ALUIZNI: Ja emrat e përfituesve në Lezhë

ALUIZNI publikon listën me 5000 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë lejet e legalizimeve.

tifikatës së pronësisë, përfituesit do të njoftohen për tërheqjen e saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarrimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyren e Regjistrimit të Pa-

bëhet nga Agjencia. Ndërkohe që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë,

të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shitë poseduesit të ndërtimit paleje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkeje me shkrim. Ndërsa

në rastin kur ndërtimi paleje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të de-

pozituara brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përpulthet vullneti. Ditën e nesërme "Gazeta Shqiptare" do të vijojë me publikimin e emrave të personave që kanë përfituar lejet e legalizimeve.

LEJET E LEGALIZIMEVE

- 09\_2133120 PAULIN PAL HILA
09\_2130601 PASHK LEKE MERDHOQI
09\_2134492 PASHK PJETER GJINI
09\_7000680 EDMOND PJETER SYZIU
09\_2130602 PASHK LEKE MERDHOQI
09\_2130060 PETRIT NIKOLL NDOKAJ
09\_2129886 FRAN ZEF BOÇI
09\_3008213 LLESH NIKOLL GJONI
09\_2130415 BIB GJERGJ GJONAJ
09\_2135951 VALENTIN PREND COLI
09\_2135950 VALENTIN PREND COLI
09\_2121038 XHEMAL MURAT ZYBA
09\_2130264 GEZIM DED SOKOLI
09\_2130195 PRENGE LLESH GJKOLAJ
09\_2121019 FRAN KOL KALTHI
09\_2123895 GJIN PJETER LLESHI
09\_2105870 MARK JAK SHQTTI
09\_2128989 ZEF NREK LLESHAJ
09\_2130475 GJON NDUJE GJERGJI
09\_2123906 FIKRI OSMAN BALAJ
09\_2107752 VIKTOR LLESH NDRU
09\_2113026 ALEKSANDER BARDHOK GJONAJ
09\_2081257 NIKOLL GJETE GJIKA
09\_8177350 LUIGJ NDUJE TUSHAJ
09\_2130586 PJETER NDUJE BIBA
09\_2137350 NOK KOL MARKU
09\_2129987 PAL NIK MARKU
09\_2131985 PILLUMB GJERGJ NDRERASHAJ
09\_2105820 PAL NIKOLL LLESHI
09\_2121083 LLESH FRROK NIKOLLI
09\_2121086 DAVE BARDHOK RAJTA ; BARDHOK, SYRJAN NDRK RAJTA
09\_3008242 SUTE NDUJE NDOU
09\_2128392 NDRK MARK UKA
09\_2126692 NDUJE MARTIN MARKU
09\_2105740 PREL MARTIN MARKU
09\_2125733 VIKTOR NIKOLL SOKOLI
09\_2130041 ZEF NDOK KOLA
09\_2134342 KOLE BIBE BUSHI
09\_2132900 PRENE PRENDUSH
NIKOLLA,DRITANA TONIN NIKOLLA / BUESHEKZA, PRANVERA TONIN NIKOLLA / PREÇI
09\_2126792 GJERGJ PJETER PERDODA
09\_2129647 GJERGJ MARK GJOKA
09\_2129418 PJETER BEC LEKAJ
09\_2129455 ÇLIRIM ZYLIF MUÇA
09\_2130010 MARTIN PAL SALLAKU
09\_2126579 AGIM ISLAM ZEQRRI
09\_2128694 NDUJE ZEF GJEÇI
09\_2118717 KOL GJOK PJETRI
09\_2129683 PETRIT MARK PICAKU
09\_2081294 PREND NIKOLL SHERRI

- 09\_2126507 DRITAN NDUJE CANGA
09\_2135926 NDOC GJON PERGJONI ZEF NDOC ZEFI
09\_2136017 ARDIANA MARKU MARKU ; EDMIR MARK MARKU ; "KLOILDA MARK PRENDAJ ; VITORE NDUJE MARKU"
09\_2130797 NIKOLL NDUJE PRENDI
09\_2127011 BARULL FRROK GJOKA
09\_2127130 HALIL BAJRAM SALIU
09\_2136125 GJET MARK MARKU
09\_2118847 FRAN GJON PERGJONI
09\_2135826 GJOVALIN TOME VULAJ
09\_2133008 ILIR GJIN BILAÇAJ
09\_2129249 GJON MARTIN PRELAJ
09\_2128656 LLESH TOME SHABI
09\_2124119 ERMIR LUIGJ STAKA
09\_2138561 NIKOLL NDRK TANUSHI
09\_2081287 DED PRENG DEDA
09\_2128882 NDUJE KOL MHILLAJ
09\_2075883 KRISTO MARK KOLA
09\_2123870 FLAMUR ASLAN MILLA
09\_2126467 NIKOLIN PAL TUSHA
09\_2122861 GJOVALIN MARK DEDA
09\_2123171 TOM NDOC SHTEJFNI
09\_2123061 LEK LLESH JAKU
09\_2120255 PASHK FRAN METAJ
09\_2120245 ALEKSANDER KOL LETI
09\_2097873 MHILL GJON GJINAJ
09\_2130378 MUHARREM VESEL LAMAJ
09\_2130377 BESNIK XHEMAL LAMAJ
09\_2129997 PASHK MARK NIKOLLI
09\_2121420 GJOVALIN KOL PERLLESHI
09\_2128807 ÇESK PAL UJKAJ
09\_2127707 VIKTOR GJELOSH ÇOTAJ
09\_2123857 KHULIAN PETRIT NDOCI
09\_8177061 PREND TOM NDOCI
09\_2123839 JAK PREK MARKU
09\_2123828 JAK NDUJE MICI
09\_2107626 NDUJE MARK PRENGA
09\_2123703 NIKOLIN PJETER PALI
09\_2123802 PASHKE NDUJE POPA;ARBEN,ALBANA,ELISABETA SIMON POPA;DIELLA SIMON SYZIU (POPA);" ROZINA SIMON PJETRI (POPA);VALBONA SIMON JAKU(POPA); VJOLICA SIMON GJINI(POPA);RUDINA SIMON NDOJA(POPA)"
09\_2123000 PAVLIN PAL PREKA
09\_2123807 LAZER PAL PEMAJ
09\_2123803 AGRON DED NDOCI
09\_2123896 PJETER VLASH PEMAJ
09\_2123695 ALTIN PJETER PEMAJ
09\_2115895 SHKELQIM KURT ALIU
09\_2123804 GJIN NIKOLL NDOCI

- SHABAN RAMAZAN MYRTA
09\_3007351 GJERGJ FRROK PALI
09\_2130247 MUSTAFA OSMAN SEFA
09\_2127233 PRENDE NDUJE GJOKA
09\_2129978 PRENG NDRK ZEFI
09\_8172578 PRENG GJETE MARKU
09\_8294760 ARBEN ZEF PRENGA
09\_2128428 ANTON NIKOLL MARKU
09\_2127129 NDUJE ZEF PALI
09\_8294492 GJON MARK BAJRAKTARI; FERDINAND GJON BAJRAKTARI;
09\_8173516 PAJTIM GJET DEDA
09\_2125386 GJON PRENG ÇUNI
09\_2078412 SEFFEDIN ALI PASHKAJ
09\_8295187 GJERGJ ZEF KEÇI ; ENKELEIDA NIKOLL KEÇI
09\_8138743 LUK DED TOMA ; EMILIANO LUK TOMA
09\_8174796 PAL NIKOLL LLESHI
09\_2130246 TOM GJIN GEGA
09\_8294807 LEK LAZER FRROKU
09\_8173427 SANDER PRENGE LLESHI
09\_8295563 NIKE PJETER BASHAJ
09\_8175395 HASAN SALI LIKA
09\_8172828 ; 09\_3010933 IZEDIN MUHARREM KADLJA
09\_3009186 AGOSTIN LAZER VESHITI
09\_8138755 GEZIM PRENG LLESHI
09\_2107652 MIRASH NDUJE LEKAJ
09\_8139915 NIKOLL NDRK LLESHI
09\_8174629 DAVIDA LAZER NIKOLLI
09\_8172925 AGUSTIN NIKOLL GJONI
09\_8306282 GJOVALIN MARASH GILAJ
09\_2125852 PRENG FRROK NDOJ
09\_8177961 FRED PAL NDOKA
09\_8175680 MHILL LULASH LULA
09\_8174018 MONDI NIKOLL NDOJ
09\_8294525 GAZMEND PRENG NIKOLLI ; GJERGJ PRENGE NIKOLLI ; PRENG MARK NIKOLLI
09\_2124050 PETRIT GJERGJ PEMAJ
09\_8308337 ALEKSANDER PJETER UJKA
09\_2130020 GJERGJ NIKOLL MATRIZI
09\_8174286 SHOQERIA V.A.LE RECYCLING SH.P.K
09\_8174285 SHOQERIA V.A.LE RECYCLING SH.P.K
KOLE GJERGJ GJERGJI ; TEREZE NDUJE GJERGJI ; NATASH SHERIF SALAJ ; NDUJE NIKE MARKU
09\_8308335 MHILL GJIN LEKA
09\_8308330 VLASH NDUJE PREÇI
09\_2138521 FLORIN TOM ÇUKU
09\_2118803 TONIN MHILL GJONI
09\_2126826 PJETER ZEF BIBA

- 09\_1000845 MARIE FRROK NIKOLLI
09\_2126559 PALI NDUJE PERVATAJ
09\_8300977 FRROK PREK VATAJ
09\_8306346 PASHKO ZEF BARDHAJ
09\_3009176 BUKURLE LUTO ALIAJ
09\_3011943 GJELOSH BARDHOK PRENDI
09\_2113139 NIKOLL NDUJE JAKU
09\_3009962 GJOVALIN NDUJE PRENGA
09\_8140656 GJON MARK MARKU
09\_3008245 EDUARD MARK PICAKU
09\_1007232 NDUJE NDUJE LUGJA
09\_8173755 PJETER NDUJE LLESHI
09\_2097775 MHILL GJERGJ NDOJ
09\_2097833 LEK GJERGJ NDOJ
09\_2123963 LEK NIKOLL BUSHKOLAJ
09\_2130843 BIBE MARK NDOCA
09\_2132966 LEK TOM MARKU
09\_2133181 MARK NIKOLL GJERGJI "ARDIANA MARK MARKU;EDMIR MARK MARKU;"KLOILDA MARK PRENDAJ; VITORE NDUJE MARKU"
09\_2126657 SIMON NDUJE NDRKA
09\_2130296 PAL ZEF SHKURTI
09\_2130905 ZEF NDUJE MARKU
09\_8308372 GJIN MARK VUKSANI
09\_8139786 MIRASH LLESHI
09\_2102977 KOL LEK PIROLI
09\_2128107 ALEKSANDER PRENG TUSHAJ
09\_8294565 DEDE NDUJE NDOJ
09\_8172280 ZEF LUK MARKU
09\_2072887 MARK CUB MANDREU
09\_2127195 ALEKS LUIGJ PRODANI
09\_2120960 NDUJE NIKOLL PRELA
09\_2127833 GJOK ZEF GJOKA
09\_2123952 ALI HAZIS GJATA
09\_8294861 GEZIM KOL DEDAJ ; MARIAN KOL DEDAJ
09\_2129112 SOKOL MARK MALUTA
09\_3009948 ROLAND MARK PJETRI
09\_2105706 LEK ZEF MARKU
09\_2123767 PAULIN FRAN PREKA
09\_8294518 LEK GJERGJ MARKU
09\_7007135 ELENI SPIRO PAPA; ELEFTERIA SPIRO LIKA; MARIA, NEKTARIA SPIRO LIKA
09\_2123883 GJERGJ NDUJE KEÇI
09\_2078391 PJETER PRENG PEPA
09\_1007252 GJOK DED KAÇORRI
09\_8308349 MARK NDUJE MARKU
09\_8308385 FRAN MARASH MARTINAJ
09\_8302828 VILSON FRROK BILAÇI
09\_8138572 FRAN GJELOSH POPAJ
09\_8174977 FRROK NDUJE LIKA
09\_2135721 FATMIR DREGUT REXHA

- 09\_8178200 GJERGJ NDUJE VULAJ
09\_8174399 GZIM LUSH MARKU
09\_8177596 MUSA RIZA KARAMUÇA
09\_8176496 MARK NIKOLLE PEMAJ
09\_2123814 FRROK NDUJE FRROKU
09\_8306909 PJETER MARK BIBA
09\_2138536 GJERGJ ZEF GJEÇI
09\_2105776 LLESH NDOK NDOJ
09\_8305645 ZEF FRROK ZEFI
09\_8308398 DASHAMIR PASHKO QUSHKU
" 09\_8175284 FERDINANT NDRKEE BRUKU ; PJERIN NDRKEE BRUKU;" PAVLIN NDRKEE BRUKU ; ANXHELINA GASPER BRUKU"
09\_8308392 PJETER PAL SHAHINI
09\_8307878 DEJVI LUIGJ SHYTI
09\_8308354 PETRIT MARK ZEFI
09\_8175442 MONDI TOM GJONI
09\_8304511 MONDI LLESH SHTEJFNI
09\_3010924 KLEMEND GEG SHAHINI
09\_8308371 PJETER KOL MENGA
09\_8177373 SANDER LAZER NDOJ
09\_8172518 MUHAMET ISA DUKA
09\_8177292 GJIN LLESH GEGA
09\_8177292 NDRK PJETER FRROKU
09\_3010925 ARBEN GEG SHAHINI
09\_8174968 TOM MARK MARASHI
09\_8177254 ZEF NDUJE GJINI
09\_8294565 DEDE NDUJE NDOJ
09\_2122800 ZEF LUK MARKU
09\_2072887 MARK CUB MANDREU
09\_2127195 ALEKS LUIGJ PRODANI
09\_2120960 NDUJE NIKOLL PRELA
09\_2127833 GJOK ZEF GJOKA
09\_2123952 ALI HAZIS GJATA
09\_8294861 GEZIM KOL DEDAJ ; MARIAN KOL DEDAJ
09\_2129112 SOKOL MARK MALUTA
09\_3009948 ROLAND MARK PJETRI
09\_2105706 LEK ZEF MARKU
09\_2123767 PAULIN FRAN PREKA
09\_8294518 LEK GJERGJ MARKU
09\_7007135 ELENI SPIRO PAPA; ELEFTERIA SPIRO LIKA; MARIA, NEKTARIA SPIRO LIKA
09\_2123883 GJERGJ NDUJE KEÇI
09\_2078391 PJETER PRENG PEPA
09\_1007252 GJOK DED KAÇORRI
09\_8308349 MARK NDUJE MARKU
09\_8308385 FRAN MARASH MARTINAJ
09\_8302828 VILSON FRROK BILAÇI
09\_8138572 FRAN GJELOSH POPAJ
09\_8174977 FRROK NDUJE LIKA
09\_2135721 FATMIR DREGUT REXHA



Opinion i Ditës

# Ecuria e reformës në drejtësi, përtej afateve dhe përcaktimeve kushtetuese

Nga Vincent W.J. van Gerven Oei

(vijon nga faqja 1)

...Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), dhe argumentova se për shkak të gjendjes aktuale të vetëingut, me shumë gjasa do të duhen disa raunde vetingu për secilin nga këto institucione që ato të plotësohen. Ky fakt automatikisht do të shkaktojë vonesa të mëtejshme në krijimin e këtyre institucioneve dhe për rrjedhojë do të vonohet instalimi i Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë Speciale (SPAK) dhe Byrosë Kombëtare të Hetimeve (BKH). Kjo do të rezultojë në zgjatjen (ndoshta të pafund) të gjendjes pa ligj në të cilën ndodhet aktualisht Shqipëria, me organet më të larta të sistemit gjyqësor të dëmtuara në mënyrë të përhershme. Që nga miratimi bipartizan i reformës së drejtësisë, dy vjet më parë, ishte e qartë për të gjithë aktorët e përfshirë se politika lëviz me një ritëm ndjeshëm më të ngadaltë se kalendari i përcaktuar në Kushtetutë. Kjo gjë është gjithashtu vënë në dukje edhe nga organizata të respektuara të shoqërisë civile, si Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Megjithatë, Komisioni Europian dhe përfaqësuesit e qeverisë amerikane në Shqipëri, sikurse vetë qeveria shqiptare janë sforcuar së tepërmi ta përshkruajnë përparimin e reformës në drejtësi si në tërësi në përputhje me "kalendarin e parashikuar". Le t'u hedhim një sy disa prej këtyre pretendimeve dhe t'i krahasojmë ato me atë çfarë po ndodhë realisht. Në tetor 2017, zëdhënësja e BE, Maja Kocijançiq? pohoi për Exit: "Duke qenë se Komisioni Evropian drejton Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, ne jemi të vetëdijshëm se fillimi dhe hapat e ndërkohës përgatitorë kanë ecur në përputhje me afatet e pritshme që institucionet e vetingut të zbatojnë detyrat e tyre". Edhe pak muaj më parë, në prill 2018, Raporti i Përparimit për Shqipërinë i Komisionit Europian, shprehej: "Zbatimi i komponentëve të ndryshëm të reformës po ecën mirë në përputhje me detyrimet ligjore, si për sa i përket hapave ashtu edhe kalendari". Më lejoni të jem i qartë: këto pohime janë të pavërteta. Për shembull, sipas Kushtetutës, KLP dhe KLGJ duhet të ishin instaluar në shkurt të vitit 2017. Prandaj, ecuria e reformës nuk është "në përputhje me detyrimet ligjore". Pretendime të tilla të dinake për afatet kohore duhet të përballen me "momentet kyçe" të reformës-formimin e organeve të reja të sistemit të drejtësisë, si SPAK-u dhe BKH-ja, të cilat varen nga formimi i KLP-së.

Në shtator 2017, ambasadorja e BE-së, Romana Vlahutin, gjatë hapjes së Shkollës Verore të BE-së, deklaroi: "Reforma në drejtësi, e cila është në fakt reforma më impjenjative dhe më komplekse nga të gjitha, është tashmë gati për t'u zbatuar me procesin e vetingut, i cili do të fillojë në më pak se dy javë. Krijimi i institucioneve të reja, përfshi prokurorinë e posaçme për korrupsionin dhe



krimin e organizuar, me shpresë (do të krijohet) nga fundi i këtij viti". Kjo nuk ndodhi. Në një përpjekje të re justifikimi, në prill 2018, ambasadori i SHBA-ve, Donald Lu shprehu besimin e tij se "Prokuroria Speciale (SPAK) dhe Byroja Kombëtare e Hetimeve (BKH) do të instalohen këtë verë". Ndërsa gjatë një diskutimi në Hagë, në maj 2018, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj tha se KLP, KLGJ dhe KED do të formohen para verës. Është e qartë asgjë nga këto nuk ka ndodhur. Ndërkohë, dokumentet e brendshme të Delegationit të BE-së në Tiranë, të marsit 2018, tregojnë se vetë ata nuk e besonin Raportin e tyre të Përparimit. Megjithatë, raporti u botua pa ndryshime dhe u bë mjet i rëndësishëm propagandistik i qeverisë "Rama". Atëherë, cilat janë tamam "afatet e parashikuara" të BE-së? Nga çfarë varen këto afate? A janë këto pikërisht afatet e sanksionuara në Kushtetutë të vitit 2016. Nëse BE ka të njëjtat afate si Kushtetuta e Shqipërisë, ne jemi qysh prej shkurtit 2017 në një vakum të papranueshëm ligjor dhe kushtetues dhe çdo afat kushtetues është tashmë i shkelur. Por, nëse afatet e BE-së nuk janë ato të Kushtetutës së Shqipërisë, atëherë është e qartë se ka një institucion tjetër "mbi" Kushtetutën shqiptare i cili po vendos afate "realiste". Por nga pohimet tërësisht kontradiktore të vetë Delegationit të BE-së nuk mund të kuptohet asnjë kalendari i qartë për formimin e institucioneve të

vetingut. Gjëja më e afërt me një kalendari që kam parë është një grafik në një prezantim të EURALIUS-it, sipas të cilit procesi i vetingut pritet të zgjasë deri në vitin 2021, në prag të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, duke e zgjatur edhe përtej mandatit të misionit EURALIUS V. Por, ky kalendari i përgjithshëm dhe aspekti specifik mund të jetë thjeshtë rezultat i dëshirës së mirë, pasi deri më tani asnjë diplomat i huaj nuk ka qenë në gjendje të ofrojë afate kohore që bazohen në hapat proceduralë të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjet e tjera të reformës dhe bazuar në ecurinë aktuale të vetingut. Për ta bërë këtë, së pari duhet të ndahen proceset e ndryshme, por të ndërlihdura që ndikojnë në kalendarin e institucioneve të reja të drejtësisë:

1. Përparimi i procesit të vetingut nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve (KPK).
2. Përparimi i trajtimit të ankimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (AKP).
3. Përparimi i ankimeve në Gjykatën Kushtetuese/Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).
4. Procedurat për instalimin e organeve të reja gjyqësore.

Progresi i vetingut i bërë nga KPK-ja është ndoshta më i qartë dhe më i lehtë për t'u vlerësuar nga pikëpamja kohore. Aktualisht janë përballur me vetingun 45 magistratë dhe KPK-ja po ecën me një mesatare prej 6-7 rastesh në javë. Nëse vazhdon ky

ritëm, nevojiten 110-130 javë të tjera derisa të gjithë magistratët të kalojnë raundin e parë të vetingut. Pra, ky proces përfundon në fund të vitit 2020. Deri tani, 8 raste janë ankmuar në KPA dhe vetëm një rast është trajtuar Koha mes apelimit të vendimit dhe zhvillimit të seancës nga KPA duket se është diku rreth 6 javë. Pra, në rast se nuk apelohej shumë vendime, KPA-ja nuk duket se luan rol të rëndësishëm në afatet kohore. Për momentin nuk ka pasur ankime të mëtejshme në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Strasburgut. Megjithatë, kjo mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt. Prokurorja Rovena Gashi tashmë ka deklaruar se nuk e pranon gjykimin e KPK-së dhe ka lënë të nënkuptohet që do ta apelojë vendimin. Apelimi në Gjykatën Kushtetuese është i mundur teorikisht, por praktikisht ajo nuk mund të shyrtojë asnjë ankesë sepse nuk ka numrin minimum të anëtarëve për kuorum. Prandaj, duke qenë se kjo gjykatë praktikisht nuk ekziston, Rovena Gashi mund t'i drejtohet Gjykatës së Strasburgut. Çdo rast vetingu i çuar në GJEDNJ do të ketë, padyshim, efekte krejtësisht katastrofike në "afatet kohore" të formimit të institucioneve të reja. Ndryshe nga Komisioni i Venecias, i cili thjesht shqyrton legjislacionin e vetingut, GJEDNJ duhet të vlerësojë të gjithë vendimet e KPK-së dhe KPA-së dhe të vendosë nëse këto institucione të posaçme janë të afta të japin një gjykim të drejtë. Duke marrë parasysh çështjet e grumbulluara në GJEDNJ, ky proces mund të zgjasë

disa vite, gjatë të cilave teorikisht krijimi i institucioneve të reja të drejtësisë do të jetë në ngërç. Sepse për sa kohë që GJEDNJ-ja nuk ka vendosur nëse një kandidat për anëtar të KLGJ/KLP/KED është shkarkuar me motivacion të drejtë apo jo, duket e pamundur që kandidatët e rinj ose zëvendësues të mund të emërohen. Çfarë ndodh nëse GJEDNJ gjen se një kandidat është shkarkuar pa të drejtë? A rikthehet ai kandidat sërish në listë? Të gjitha këto janë pasiguri të tmerrshme ligjore që po mbitmërojnë procesin e vetingut dhe janë të paprecedenta në historinë ligjore dhe politike të Shqipërisë. E askush nuk është duke diskutuar apo duke marrë parasysh pasojat e tyre. Tani, le të supozojmë për momentin se si me magji, një katastrofë e tillë nuk do të ndodhë. Si ndikojnë në të vërtetë procedurat e zgjedhjeve për KLP dhe KLGJ në afatin e vetingut? Siç e kam shpjeguar më parë, raundi aktual i vetingut do të lërë një numër të pamjaftueshëm kandidatësh për KLP dhe KLGJ që e kanë kaluar vetingun. Ky parashikim është tashmë fakt për KLGJ-në, dhe me siguri do të ndodhë shumë shpejt dhe për KLP-në. Për pasojë, duhet të mbahet një raund i ri aplikimesh, të cilat mund të hapen vetëm pasi Kuvendi të rinisë punën në shtator. Pasi të mbahet raundi i ri, çdo listë e kandidatëve do të duhet të miratohet në Kuvend, proces i cili sipas Kushtetutës duhet të marrë më pak se një muaj, edhe pse vetë procesi i zgjedhjeve është shumë i komplikuar dhe do të ketë nevojë për bashkëpunimin e opozitës. Duhet të kujtojmë se herën e fundit ky proces u dëmtua nga procedurat e paligjshme që zbatoi kryetari i Parlamentit, Gramoz Ruci, ndërkohë që marrëdhëniet politike mes shumicës e opozitës janë përkëqësuar seriozisht. Nëse PS do të miratonte e vetme një listë të shtesë kandidatësh, kjo do të nënkuptonte politizimin e plotë të organeve të reja drejtuese të sistemit të drejtësisë dhe një dështim shkatërrues të reformës në drejtësi. Nëse përsëri, me anë të ndonjë mrekulie, gjendet konsensusi politik, dosjet e këtyre kandidatëve të rinj duhet të hapen dhe vlerësohen nga KPK-ja, e kështu me radhë. Ka pak mundësi që kjo të ndodhë deri në fund të vitit 2018. Për KED-në situata është edhe më e keqe. Nëse vetingun nuk e kalojnë të gjithë anëtarët e KED-së, Gjykatë Kushtetuese nuk mund të formohet. E njëjta gjë do të ndodhë nëse edhe KED-ja e vitit të ardhshëm nuk e kalon vetingun, e kështu me radhë derisa të jenë verifikuar të gjithë magistratët, kështu që në KED nuk do të zgjidhet asnjë anëtar i pavetuar. Kjo do të thotë që Gjykatë Kushtetuese rrezikon të jetë e paralizuar deri në vitin 2021, ndërsa qeveria duhet të votojë ndryshime thelbësore në Kodin Zgjedhor para zgjedhjeve të vitit 2021, të cilat me siguri do të apelohej në Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk do të ekzistojë. Ja pra se çfarë do të thotë afat kohor realist.



Kurti: Të krijohet një grup parlamentar që t'i formulojë kërkesat Serbisë

# Thaçi: S'ka forcë të na detyrojë të bisedojmë për ndarje

## Dialogu për territorin, tensionohet gjendja në Kosovë

**D**ebati për fazën e fundit të dialogut me Serbinë në Kosovë ka tensionuar raportet mes partive politike. Në mediat vendase vazhdimisht shkruhet për "ndarje të mundshme të Kosovës apo shkëmbim territoresh me Serbinë". Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, siguroi qytetarët e Kosovës se, "nuk do të ketë asnjë forcë që do të detyrojë Kosovën të diskutojë për ndarjen e vendit". Presidenti hodhi kritika edhe të disa përfaqësues politik për hedhjen e ideve për ndarje apo shkëmbim territoresh. Debati për fazën e fundit të dialogut me Serbinë në Kosovë, që vazhdoi të hënën edhe në parlamentin e Kosovës ka tensionuar raportet ndërmjet partive politike, ndërsa, në medie të ndryshme vazhdimisht shkruhet për "ndarje të mundshme të Kosovës apo shkëmbim territoresh me Serbinë", si një marrëveshje e mundshme përfundimtare ndërmjet dy vendeve. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili tash për tash udhëheq dialogun me Serbinë dhe që ai kundërshtohet nga opozita kosovare, tha të martën (31.07) në një konferencë për medie se "në dialogun me Serbinë në Bruksel, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, nuk do të ketë forcë që do të detyrojë palën kosovare që ta flasë për ndarjen e Kosovës".

"Si president i vendit edhe njëherë i siguroj qytetarët e Kosovës se nuk do të ketë forcë që do ta detyrojë Kosovën të diskutojë, e lëre më të pajtohet me ndarjen e saj. Nuk do të lejoj, as të diskutohet e lëre më që dikush të pajtohet me ndarjen e Kosovës. Janë shqetësuese zërat që flasin gjëra të tilla, kur në të vërtetë gjërat e tilla po kalojnë së fundi edhe nga njerëzit që kanë legalitet edhe në institucionet e vendit", u shpreh Presidenti Thaçi, duke siguruar njëkohsisht se nuk do të ketë as boshnjëzim të Kosovës. Ajo dhe Serbia, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian duan që të fillojnë fazën finale të dialogut për arritjen e një marrëveshjeje



Hashim Thaçi

### ALBIN KURTI

"Përpara çfarëdo dialogu të ri me Serbinë, janë të domosdoshme katër etapa përgatitore, që nënkupton, shqyrtim dhe vlerësim i dialogut 2011-2017 dhe rezultateve të tij, e dyta synimet e Kosovës dhe kërkesat tona ndaj Serbisë, e treta parimet dhe kushtet e dialogut të ri dhe e katërta ekipi, ynë negociator me strategji dhe udhëheqës të ri", thotë Kurti.

je përfundimtare ligjrisht të detyrueshme, që do të përmirëson raportet ndërmjet dy vendeve. "Kjo marrëveshje, për Kosovën nënkupton një reciproke. Ne do të punojmë fuqishëm që marrëveshja finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të jetë në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve. Me këtë marrëveshje Kosovës do t'i hapet mundësia që të anëtarësohet

në organizata ndërkombëtare", u shpreh presidenti Thaçi, i cili kërkon që të jetë në krye të një ekipi negociator të Kosovës për biseda me Serbinë. Por, këtë rol të presidentit po e kundërshtojnë partitë politike opozitare, megjithëse ato nuk mundën që ta miratojnë në parlament të hënën një rezolutë që do t'ia kontestonte rolin udhëheqës presidentit në dialog. Me anë të kësaj rezolute kërkohet po

**HASHIM THAÇI**  
"Nuk do të ketë asnjë forcë që do të detyrojë Kosovën të diskutojë për ndarjen e vendit. Kjo marrëveshje për Kosovën nënkupton një reciproke. Ne do të punojmë fuqishëm që marrëveshja finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të jetë në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve. Me këtë marrëveshje Kosovës do t'i hapet mundësia që të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare", thotë presidenti kosovar.

ashtu që Kuvendi të mandaton të udhëheqësin e dialogut me dy të tretat e votave. Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, kërkon nga deputetët që të bashkohen, sikurse thotë, në ekipin gjithëpërfshirës për hartimin e një platforme të përbashkët për përfaqësimin e Kosovës në dialog. "Ajo që dua t'ju lus si deputetë është se një temë e vendit tuaj mund të shrohet në tavolinat e vendim-marrjeve edhe pa kontributin tonë, edhe pa rolin tonë, dhe mund të ecin disa procese në mënyrën si kanë ecur në të kaluarën, e pastaj i kemi vajtuar qindra vjet ose kemi provuar t'i kalojmë, por ka qenë vështirë. Për këtë arsye, dua t'iu them merrni në dorë procesin e ardhshëm të dialogut si Par-

lament i Kosovës", u tha deputetëve kryeministri Haradinaj. Ndërkohë, lideri i lëvizjes Vetëvendosja Albin Kurti, thotë se është e dialogut me Serbinë nuk është çështje procedurale, por është çështje përmbajtësore. "Përpara çfarëdo dialogu të ri me Serbinë, janë të domosdoshme katër etapa përgatitore, që nënkupton, shqyrtim dhe vlerësim i dialogut 2011-2017 dhe rezultateve të tij, e dyta synimet e Kosovës dhe kërkesat tona ndaj Serbisë, e treta parimet dhe kushtet e dialogut të ri dhe e katërta ekipi ynë negociator me strategji dhe udhëheqës të ri", thotë Albin Kurti, duke propozuar që të krijohet një grup i përbashkët parlamentar dhe t'i formulojë kërkesat e Kosovës ndaj Serbisë. Me gjithë këto debate, rezoluta në kuvend për dialog me Serbinë nuk kaloi për mungesë kuorumi të deputetëve. Sidoqoftë, Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog që nga viti 2011. Janë arritur një sërë marrëveshjeshe, por tash nga Bashkimi Evropian po kërkohet një marrëveshje përfundimtare që do të përmirësonte marrëdhëniet ndërmjet të dyja vendeve. Në takimin e fundit që dy presidentët zhvilluan në Bruksel Hashim Thaçi dhe Aleksandër Vuçiq, megjithëse u shprehën për takim të vështirë, ata u pajtuan që "të intensifikojnë punën në javët në vazhdim", në kërkim të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ligjrisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

### SHKURT

**Ndryshimi i madh i Gjermanisë, 1 në 4 banorë me origjinë të huaj**

**N**ë Gjermani çdo i katërti person ka prejardhje të huaj. Vitin e kaluar ky numër u rrit edhe më shumë. Grupimin më të madh të të huajve e përbëjnë turqit. Numri i individëve me prejardhje të huaj në Gjermani ka arritur një rekord të ri në vitin 2017. Siç bëri të ditur, Zyra Federale e Statistikave në Republikën Federale të Gjermanisë jetonin vitin e kaluar 19,3 milionë gra, burra e fëmijë që kanë sfond migrimi. Kjo përbën 4,4% më shumë se një vit më parë. Pjesa e përgjithshme e të huajve në numrin e popullsisë gjermane përbën 23,6%. Në Gjermani një person quhet me sfond migracioni, kur ai vetë, ose njëri nga prindërit nuk ka lindur me shtetësi gjermane. Rreth 51% e popullsisë së sfond migrimi janë gjermanë, 49% kanë një pasaportë të huaj. Ndër 19,3 milionë individë me origjinë të huaj në Gjermani, 2,8 milionë kanë prejardhje turke, 2,1 milionë janë me origjinë polake, 1,4 milionë me origjinë ruse, 1,2 milionë me origjinë kazake dhe 0,9 milionë me prejardhje rumune. Të dhënat bazohen në mikrocensurin, regjistrimin sporadik ku çdo vit pyetet 1% e popullsisë në Gjermani. Statusi i migrimit u pyet tek personat abanes privatë dhe jo në qendra komuniteti.

**Rrëzohet avioni me 101 persona në bord**

**N**jë avion pasagjerësh është rrëzuar në Durango, Meksikë, vetëm pak minuta pas ngritjes. Gubernatori i shtetit José Rosas Aispuro tha se nuk kishte viktima në mesin e 101 anëtarëve në bord, edhe pse rreth 85 persona u plagosën. Sipas 'BBC', shumica e pasagjerëve arritën të largoheshin para se zjarri të shpërthente. Emrat dhe kombësitë e personave në bord nuk janë identifikuar ende. Fluturimi 'Aeroméxico' AM2431 po fluturonte nga Aeroporti Ndërkombëtar i Guadalupe Victoria për në Meksiko. Autoritetet thanë 37 persona u shtruan në spital, dy prej të cilëve janë në gjendje të rëndë. Shefi ekzekutiv i kompanisë ajrore, Andres Conesa, tha se njëri nga pilotët kishte pësuar lëndime. "Kapiteni i fluturimit po operohet. Ai është jashtë rrezikut për jetën", tha ai. Operatori i aeroportit, Grupo Aeroportuario Centro Norte, tha se sipas të dhënave, shkak ishte bërë moti i keq dhe se avioni ishte nisur gjatë një stuhie të madhe para se të detyrohej të bënte një ulje emergjente.

Serbia po "lufton" kundër Perëndimit që njohu pavarësinë e Kosovës

## Aleksandër Vuçiq: S'do lejojmë që SHBA dhe Bashkimi European të na ngrenë për 'veshësh'

**N**ë një intervistë për televizionin serb 'Pink', presidenti serb, Aleksandër Vuçiq deklaroi se ata nuk luftojnë kundër shqiptarëve, por kundër shumë vendeve perëndimore të cilat qëndrojnë pas pavarësisë së Kosovës. "Të nxjerrim sa më tepër që mundemi, e të humbim më pak se që jemi të detyruar, kjo është ajo për të çfarë, në kushte gati të pamundura, po luftojmë kur bëhet fjalë për Kosovën", ka thënë dje Vuçiq, duke shprehur bindjen se nuk do të fitojnë më pak se ajo çfarë iu është ofruar. Ai ka përsëritur se po luftojnë kundër shumë vendeve perëndimore, të cilët e përkrahin pavarësinë e Kosovës duke përfshirë edhe Britaninë e Madhe. "E shihni çfarë është duke bërë Britania e Madhe nëpërmes agjenturave të saj në Serbi, Kosovë dhe Maqedoni. Ne po luftojmë në kushte shumë të vështira, gati të pamundura

të nxjerrim sa më shumë që mundemi për popullin tonë, e të humbasim sa më pak", ka thënë ai, transmeton "Insajderi.com". Ai ka përkujtuar se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konstatuar se pavarësia e Kosovës është zbatuar në mënyrë legale, dhe kështu është kryer - me kërkesë të Serbisë. "Ne nuk kemi kërkuar arbitrazh nga ekspertët të cilët na përkrahin, por prej GjND-së", ka thënë ai. Duke komentuar "Tweet"-in e priftit serb nga Kosova, Sava Janjić, në të cilin thuhet se ka dëgjuar informata të rrezikshme mbi një marrëveshje për një incident në Kosovë, i cili do të ishte shkrehës për reagim nga të dyja




Aleksander Vučić

### ALEKSANDËR VUÇIQ

"Të nxjerrim sa më tepër që mundemi e të humbim sa më pak. Kjo është ajo për të çfarë, në kushte gati të pamundura, po luftojmë kur bëhet fjalë për Kosovën. S'do të lejoj që Serbinë ta ngrehë për 'veshësh' as SHBA-të, as BE-ja, e as kushtdo që punon në interes të tyre", ka thënë presidenti serb, Vuçiq.

palët dhe hyrje për ndarje në terren, ai ka thënë: "Po më sillni në situatë të përgjigjem në thasethemet e pahijshme, jonjerëzore, në tregimet e kota. Këtu nuk ka informata. Këto tregime të kota po i trillojnë kundërshtarët tanë politikë nga Lidhja për Serbinë e Lirë. Nëse do Zoti, kjo kurrë nuk do të ndodhë, asnjë njeri nuk do të pësojë, as në veri as në jug të Kosovës", ka thënë Vuçiq. Ai gjithashtu ka thënë se nuk do të pranojë atë çfarë ka ndodhur në Maqedoni dhe se do t'i prezantojë popullit planin e vet për Kosovën ashtu si është dhe se populli do të deklarojë për të. Gjithashtu ka theksuar se shumë njerëz më tepër do ta preferonin praninë e NATO-s sesa të ushtrisë serbe. Për këtë ai ka thënë se "nuk do të lejoj që Serbinë ta ngrenë për 'veshësh' as SHBA-të, as BE-ja e as kushtdo që punon në interes të tyre".

**Fjalëkryqi (1)**



34. Eshhtë mjeshtri me... baketë.  
 37. Digjen po nuk u zbuluan.  
 39. Igli të Lazio.  
 41. Kush del... mbështet.  
 42. Mund të jetë unik.  
 46. Ngrihen për atentate.  
 47. Janë fjetore në kazerma.  
 48. Altini mesfushor.
- VERTIKAL  
 1. Fillojnë matanë.  
 2. Një Hans artist dadaist.  
 3. Eshhtë mjet rrethanor tundrimi.  
 5. Eshhtë ënjtje.  
 6. Lumi i Elizit.  
 7. Fillojnë mpirjjen.  
 8. Eshhtë e gjithë Hëna.  
 10. Eshhtë qetësues për neurozat.  
 11. Taylor aktore.  
 12. Daniel i Robinson Crusoe.

HORIZONTAL

1. Hari piune.  
 4. Janë toksike.  
 9. Gjysmë arrest.  
 10. Janë vende pa ne.  
 13. Johnny i Donnie Brasco.  
 15. Priten nga meridianë.  
 18. Me të nxjerrin një letër.  
 20. U verbua nga Askushi.  
 21. Një britmë në arenë.  
 22. Shkrimtari i J'accuse.  
 24. Si moral.  
 25. Nota e diapazonit.  
 26. Me dies në një liturgji.  
 27. Një mund të jetë edhe veprimi.  
 28. Eshhtë e re pas Krishtit.  
 29. Inicialet e Bergman aktore.  
 30. Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.  
 32. Fise pa fe.  
 33. Një provë zjari.

14. Kështu janë skenat që mallëngjejnë.  
 16. Eshhtë pjesë në skenë.  
 17. Lëvizje Ekologjike Lokale.  
 19. Përshkohej nga Leti.  
 22. Eshhtë muzika më e... kollajtë.  
 23. Grazia Cucinotta aktore.  
 24. Veriu pa ekstreme.  
 27. Janë tre në trickilë.  
 30. Scola, regjisor italian.  
 31. Kufizojnë një metër.  
 34. Mbahet me inat.  
 35. Mbyllin kurse.  
 36. Ka një shpejtësi fantastike.  
 38. Laik kur s'është ai.  
 40. Një liqen i kripur.  
 43. Një mund të jetë fetar.  
 44. Eshhtë lloj papagalli.  
 45. Në hyrje të sallës.  
 46. Priten në skaje.

**Fjalëkryqi (2)**

HORIZONTAL


1. Janë lokale me kubiste.  
 9. Me të nxjerrin në tapë.  
 11. Polanski regjisor.  
 12. Qeni i famshëm i Odiseut.  
 15. Mbeten në fund.  
 16. Gabon në ekstreme.  
 18. Rreh në kufij.  
 19. Eshhtë vepër për një... vepër.  
 23. Janë udhëtime për në një vend të shenjtë.  
 25. Dinë shumë gjuhë.  
 26. Një mendim.  
 27. Famëkeqi Capone.  
 28. Kush i kthen... të braktis.  
 29. Kisha pa zë.  
 30. I fejuari i kukullës Barbie.  
 32. Ritet pa re.  
 33. Një brinjë në skuadër.  
 35. Emri i Zola.

VERTIKAL


37. Eshhtë mosha e të miturit.  
 40. Një dispozitiv kohe.  
 41. Janë strehë për barinj.  
 42. Fillojnë aksionin.  
 43. Eshhtë ai që nuk qesh.  
 45. Të parat në ambient.  
 46. Gjysmë teorie.  
 47. Një binar.  
 48. Djeg kur bie.

VERTIKAL


1. Barrymore aktore.  
 2. Tiriq që qe tenist.  
 3. Ekstreme në studim.  
 4. Eshhtë kleri me papën.  
 5. Ndezur në aparturë.  
 6. Kaluar në krye.  
 7. Janë racë e pastër.  
 8. Një treg pa re.  
 10. Duhet fituar me djersë.  
 13. Një dritë për sake.  
 14. Lëvizin pasi mendohen shumë.  
 16. Janë sfera për bingo.  
 17. Eshhtë më pak se nxehtësi.  
 19. Gibson aktor.  
 20. Tregonin skllëvër dikur.  
 21. Mund të jenë fetare të tilla.  
 22. Kush nuk ka... nuk i ecën.  
 23. Një sherr në shtyp.  
 24. Një lidhëz.  
 25. Mund të jenë cigaresh.  
 29. Mund të bëjë zoom.  
 31. Ndërmarrje Industriale Mirditë.  
 33. Pak konkrete.  
 34. Eshhtë i mirë me shokë shumë.  
 36. Artikull për shumë francezë.  
 38. Kanto kur nuk... ka.  
 39. Muzika me jam session.  
 44. Mbyllin një sherr.  
 45. Të fundit në sirtar.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

R	E	S	H	A	T	M	I	S	T	E	R	E
P	R	A	P	E	S	I	T	U	D	O	R	
M	I	T	U	R	A	N	D	O	T	M	O	
A	R	M	A	R	E	N	D	A	L	E	S	A
R	O	T	F	E	D	E	R	A	L	I	E	I
S	T	D	E	K	O	R	A	T	A	D	K	
H	E	R	E	T	I	K	E	A	A	E		
T	E	T	A	P	A	T	P	A	L	M		
M	C	L	A	R	E	N	P	O	S	T	A	R
H	A	R	E	T	S	I	R	T	A	R	I	
N	D	E	A	M	A	T	O	R	E	T		
R	A	M	S	E	R	A	F	I	N	E	T	
C	A	P	O	N	E	K	S	K	A	F	I	
O	D	I	N	I	P	O	R	S	K	R	A	V
R	A	S	A	R	E	S	T	B	I	M	E	S
R	E	K	M	I	L	I	M	E	T	R	I	O
T	I	M	O	N	O	T	O	N	I	A	O	
D	E	L	I	K	A	T	E	A	K	T	E	T
A	N	E	T	A	R	E	T	T	E	N	T	
P	D	M	I	T	P	I	R	A	T	I		
L	O	H	A	N	Z	E	M	E	R	I	M	I
A	R	E	N	A	I	T	E	T	E	A	R	
K	A	P	I	T	A	L	E	T	S	I	T	A

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOK**

7	3			5	
	4			6	
		1		9	5
5				1	9 2
			4 7	5	8
3			7 2		
6 9				2	
		6 3		4	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	3	6	8	4	2	9	1	5
2	4	1	7	9	5	3	6	8
5	9	8	1	6	3	2	4	7
9	7	4	2	5	8	6	3	1
3	6	5	4	1	9	7	8	2
1	8	2	3	7	6	4	5	9
8	5	3	9	2	4	1	7	6
4	1	9	6	8	7	5	2	3
6	2	7	5	3	1	8	9	4

**Argëtim filozofik**

- Mos kujtoni se nuk ka kafshë, vetëm dhe vetëm sepse pylli është i qetë ...
- "Mos u gënjini duke besuar se një njeri i pasur është domosdo i zgjuar. Ka mjaft prova që vërtetojnë të kundërtën".
- Ekzistojnë krime më keq se sa të djegësh libra. Një nga këto është të mos i lexosh.
- Sa më shumë i ndershëm njeriu, aq më i keq fati i tij.
- Nuk jemi genie njerëzore që kanë përvojë shpirtërore. Jemi genie shpirtërore që kanë përvojë njerëzore.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

9	1	2	4	16	17	17	18	19	19	20	21	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100																							
I	R	A	K	F	O	R	A	R	I	S	P	I	L	O	T	E	T	M	N	P	I	R	A	T	E	T	A	T	A	K	P	I	T	A	G	O	R	A	M	L	A	E	S	U	G	O	F	A	R	R	T	L	N	R	R	A	R	E	N	A	B	A	L	A	A	E	T	O	P	A	T	A	T	I	T	F	B	A	A	R	L	L	M	A	E	F	E	L	A	R	T	E	L	U	I	S	T	A	L	E	N	T	E	T	E	A	I	T	A	I	T	E	M	E

**Thënie të mençura**

- Gratë e bukura kurrë nuk dyshojnë në inteligjencën e vet, por gratë inteligjente gjithë dyshojnë në bukurinë e vet.
- Disa meshkuj kanë atë që e kanë merituar, të tjerët janë të pamartuarit.
- Të arsimosh një mashkull do të thotë të arsimosh një person;
- të arsimosh një femër, do të thotë të arsimosh një shoqëri.
- Gjithkush sheh atë që dukesh. Pak kujtojnë atë që jeni.
- Një gënjeshtrë në momentin e duhur është 100 herë më e mirë se sa një e vërtetë në momentin e gabuar.

